



AKTUALITET



**BASHKIA E BULQIZËS,
BASHKËPUNIM
ME AMBASADËN E
KATARIT**

Faqe 3

PROMOVIMI



**DËRGESAT E
HALIL RAMËS NË
"PANAIRIN" E
VLERAVE**

PROF. DR. GAFUR MUKA

Faqe 8

LIBRI



**STOMATOLOGJIA
NË SHQIPËRI NGA
LASHTËSIA DERI
NË DITËT TONA**

Vepër studimore-shkencore nga Prof. Dr. Nazmi Koçi

Faqe 6

Bordi i Federatës së Paqes Universale, Shqipëri vlerëson njërin nga sipëmarrësit më të suksesshëm në rang vendi

BUKUROSH KOÇI, AMBASADOR I PAQES

REPORTAZH

Le ta quaj: 36 orë në BULQIZË

MARTIN CUKALLA

Ylli Pepo është në përfundim të një filmi. Historia e Bulqizës dhe historiku i nxjerrjes së kromit aty, natyra me ashpërsitë dhe bukuritë e veta, njerzit që punuan dhe ata që përpunonin të afrojnë vatanin e tyre në planet moderne të jetës! Aspekte, natyrisht aspekte njerzore e pamje të veçanta nga ajo madhështi që përmbledhet në një emër të veçantë për mua: Bulqiza! Ky është thelbi i film-it të Ylli Pepo-s me skenar të gazetares së mirënjohur Zana Zyrakja, autore e qindra emisioneve në Radio Tirana dhe dhjetra filmave dokumentarë e artistikë në Televizionin Shqiptar.

Ndërsa po përmbyll filmimet, Ylli më ftoi ta shoqëroj në Bulqizë, në një udhëtim të shkurtër për të marrë disa sekuenca që kompletojnë rregjizurën.

Interesant, mendoj, artisti punon drejtpërdrejtë me jetën që zhvillohet dhe zbulon në vepër të gjithë kompleksitetin që mbart koha dhe hapsira, politika drejtpërdrejtë në zhvillimet zbulon interesat dhe grupet e interesit që i nevoiten për tu votuar!

Ylli Pepo kërkon njerëzit që bëjnë të renë europiane të Shqipërisë së sotme dhe veprat e tyre kudo ku ndodhen, por edhe prej të shkuarës ngre në ekran figurat e shquara që të mos lërë kohën të fshehtë magjitë e jetës së tyre dhe bëmat në të cilat kombi ynë ngjiti shkallët e përparimit! Kujtoj filmat e sivjetëm të tij për Tefta Tashkon e Korçës, Jakov Xoxen e Fierit, durrakun Andrea Alessi, vlonjatin Ali Asllani etj.

Vijon në faqen 4-5



• *Ing. Bukurosh Koçi, të cilit në vitin 1980 i refuzohej e drejta e studimeve të larta për "njolla në biografi" sot është ndër sipëmarrësit më të suksesshëm. Autori i disa studimeve të kryera për pasurimin dhe parapasurimin e mineraleve të kromit në zonën e Bulqizës, Batrës, Krastës, Tërmovës, Kukësit, Tropojës, Hasit etj, si dhe bashkëpunëtor në kryerjen e disa studimeve nga Instituti i Studimeve të Teknologjisë së Mineraleve, Tiranë*

Faqe 3

LIBRI

Faqe 8

"UDHËTIM NDËR VITE NË TREVAT ETNIKE SHQIPTARE TË MAQEDONISË"

Një publikim dinjitoz i studiuesit Ymer Keta

NGA DR. ADRIATIK BALLA

PROFILI

Faqe 12-13

Skënder Murrja – 40 vjet mësues dhe drejtor shembullor

PORTRET

Faqe 7

Emiljano Hoxha- Inxhinieri bulqizak, drejtues projektsh në Gjermani dhe Zvicër

IN MEMORIAM

Faqe 13 - 14

Homazh i vonuar për Dr. Ahmet Kamberin


HOMAZHE

Faqe 13 - 14

**Dr. Sabri Toska mjeku i shquar e i paharruar i Bulqizës
LANTUMIRË JASHAR GJOKA, INXHINIERI E DREJTUESI I GJEOLOGJISË SË BULQIZËS**

BASHKIM LAMI

SUPLEMENTI LETRAT



Poezia e Dhurata Kolës , si gjithprani e këndshme

DR. HAJRI MANDRI

Poezi nga Barie Çupi, Bruna Musai dhe Shuip Elezi

Faqe 10 - 11

BORDI I FEDERATËS SË PAQES UNIVERSALE, SHQIPËRI VLERËSON NJËRIN NGA SIPËMARRËSIT MË TË SUKSESSHËM NË RANG VENDI

vlerësim

BUKUROSH KOÇI, AMBASADOR I PAQES

• *Ing. Bukurosh Koçi, të cilit në vitin 1980 i refuzohej e drejta e studimeve të larta për "njolla në biografi" sot është ndër sipërmarrësit më të suksesshëm. Autori i disa studimeve të kryera për pasurimin dhe parapasurimin e mineraleve të kromit në zonën e Bulqizës, Batrës, Krastës, Tërrovës, Kukësit, Tropojës, Hasit etj, si dhe bashkpunëtor në kryerjen e disa studimeve nga Instituti i Studimeve të Teknologjisë së Mineraleve, Tiranë*

HALIL RAMA – MJESHTËR I MADH

Në këto kohë të ringjalljes së konflikteve ndëretnike dhe të thellimit të krizës globale, të promovosh paqen universale është shërbimi më i mirë që mund t'i bëhet njerëzimit. Këtë shërbim po e bën më së miri Federata e Paqes Universale – Shqipëri, e cila në harkun kohor të dy dekadave (nga viti 2005 kur ka nisur aktivitetin në Shqipëri dhe Kosovë) u ka dhënë titullin "Ambasador për Paqe" 6000 personaliteteve të nderuara të botës akademike, artit, kulturës e letrave, të sportit e sipërmarrjes në dy shtetet shqiptare.

Më së miri e ka kryer këtë mision Këshilli i Paqes Tiranë që drejtohet me përkushtim të rrallë e profesionalizëm të spikatur nga kreu i këtij Këshilli, ikona e gazetarisë sportive dhe e dokumentarit televiziv, Defrim Methasani. Në një nga eventet e këtij Këshilli, nën logon "KATOLINA E PAQES", në vigjilje të festave të fundvitit: Krishtlindjeve dhe Vitit të ri 2024, mes dhjetra personaliteteve nga Shqipëria e Kosova, titulli "Ambasador i Paqes" ju dha edhe Bukurosh Koçit, ndër sipërmarrësit më të suksesshëm në rang vendi.

E kush më mirë se Ai, e meriton këtë titull?! Ndaj dhe qindra pjesëmarrësit në sallën moderne të Federatës së Paqes Universale në Tiranë, Ai do t'i magjepste me fjalët e ngrohta, me sytë shkëlqimtarë, me mençuri të rrallë, vizionar si askush, si misionar i vërtetë i mishërimit të paqes në çdo qelizë të tij. Sepse Bukurosh Koçi prej katër dekadash është bërë shembull frymëzimi për mijëra minatorët e nëntokës së Bulqizës. Ndaj dhe këtë titull ua dedikon pikërisht atyre heronjve të nxjerrjes së mineralit të çmuar të kromit nga miniera e Bulqizës, që nga thellësitë e nëntokës çdo ditë frymëzojnë si simbol i solidaritetit dhe paqes me tyre.

Këshilli i Paqes për Tiranën ka bërë përzgjedhjen më të mirë, duke i dhënë titullin "Ambasador i Paqes" Bukurosh Koçit, këtij inxhinieri të talentuar me një CV mjaftë impresionuese.

Z. Bukurosh Koçi – ka përfunduar studimet në Fakultetin Gjeologji Miniera në Universitetin e Tiranës në vitin 1985. Për 3 vite punoi si Inxhinier Pasurimi në Fabrikën e Pasurimit të Kromit në Bulqizë. Në vitet 1988 – 1992 punon si Kryeinxhinier pranë fabrikës dhe në 1992 nis biznesin e tij privat. Në vitet 1996-1998 shërben si Zv. Drejtor i Minierës së Kromit në Bulqizë dhe prej vitit 2001 është Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë "Fabrika Pasurimit të Kromit" Bulqizë. Njeri humanist që ka ndihmuar shumë njerëz në nevojë.

Ing. Bukurosh Koçi, të cilit në vitin 1980 i refuzohej e drejta e studimeve të larta për "njolla në biografi" sot është ndër sipërmarrësit më të suksesshëm. Autori i disa studimeve të kryera për pasurimin dhe parapasurimin e mineraleve të kromit në zonën e Bulqizës, Batrës, Krastës, Tërrovës, Kukësit, Tropojës, Hasit etj, si dhe bashkpunëtor në kryerjen e disa studimeve nga Instituti i Studimeve të Teknologjisë së Mineraleve, Tiranë; po ashtu autor dhe bashkautor i ndërtimit të disa Fabrikave e impianteve për pasurimin e mineralit të kromeve të varfëra, si dhe i disa rikonstruksione Fabrikash Pasurimi, ka ngritur e konsoliduar një Shoqëri nga e cila janë përpunuar dhe vazhdojnë të ripërpunohen mbi 2.5 milion ton sterile dambe, duke prodhuar koncentrat kromi për eksport. Sot në këtë shoqëri që po mbush afro 24 vjet, punojnë rreth 100 punonjës të profesioneve inxhinierë miniere e gjeologjie, teknologë, mekanikë, elektrike, manovratorë e shoferë. Ai shprehet për përfshirjen më të gjerë të shoqërisë, jo vetëm në përpunim por dhe prodhim të lëndës së parë, qoftë dhe për krome të varfëra, duke vërejtur se sasia e sterileve që mund të riciklohet po shkon drejt përfundimit, ndaj orientimit të ri të shoqërisë dhe drejt objekteve të



reja të shfrytëzimit të kromit apo dhe kërkim-zbulimit të trupave të rinj minerare.

Në Fabrikën e Pasurimit të Kromit Bulqizë, B.Koçi realizoi këtë vit një "revolucion teknologjik". Pasi ka sjellë dhe implementuar teknologjitë më të përparuara botërore në mjediset e fabrikës, Administratori i saj, Ing. Bukurosh Koçi, realizoi një tjetër investim madhor. Projekti konsiston në instalimin e paneleve diellore, për realizimin e të cilit u investuan 840 mijë euro. Është një investim që do i shërbejë perspektivës, duke ulur në maksimum shpenzimin e energjisë elektrike.

FEDERATËS UNIVERSALE TË PAQES JU SHTUAN 10 AMBASADORË TË RINJ

Në takimin përmbyllës të fundvitit 2023 të titulluar "Kartolina e Paqes" që zhvilloi Këshilli i Paqes Tiranë, përveç Bukurosh Koçit, me titullin "Ambasador i Paqes" u vlerësuan edhe personalitete të tilla si:

Astrit Hafizi që ka dhënë kontributin e tij ndër breza të shkëlqyer futbollistësh; ai që me fanellën kuqeblu, do të shpallej kampion në vitin 1978 dhe 1983 dhe që njëkohësisht, ka fituar edhe dy Kupa Shqipërie, në vitin 1979 dhe 1981..., që pas Vllaznisë, në vitet 1997 - 1999, ka drejtuar Kombëtarën e Shqipërisë dhe që për kontributin e tij, është nderuar me titullin "Mjeshtër i Madh".



Prof.dr. Shefqet Hoxha – Mjeshtër i Madh, autor i 82 librave me monografi dhe i 556 artikujve kulturorë e shkencorë.

Gazetarja nga Prizreni Alba Alishani – është është nga Prizreni e njohur si prezantuese emisionesh në TV e Prizrenit, moderatore, prezantuese festivalesh dhe kopmeticionesh; gazetare e mirënjohur në Shqipëri në Shqipëri, në TV Klan, ABC Neës, TV A1 Neës, në Ora Neës- Aktualisht është Producente dhe Prezantuese Emisioni pranë A2 Cnn.

Dashnor Bajaziti – që në Kavajë quhet "Ylli që u kthye në legjendë"; ish Zevendësministër i Sporteve në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në vitet 2010-2014; fitues i çmimeve "Mjeshtër Sporti", "Nderi i Sportit Shqiptar" dhe "Mjeshtër i Madh" nga Presidenti i Republikës.

Bislim Hoti, që pas luftës në Kosovë ishte pjesë e Këshillit tranzitor të Kosovës; që ka mbajtur postin e deputetit për dy mandate dhe në fund të mandatit ishte Nënkrjetar i

Kuvendit të Kosovës. Qellimi dhe ativiteti i tij politik vazhdoi deri në shpalljen e Pavarsisë së Kosovës.

Alisa Baraku, këngëtare e mirënjohur nga Tirana, me talent të rrallë, një pedagoge e shkëlqyer e kantos, një bashkëshorte e Frederik Ndoci dhe një nënë shembullore.

Neshat Ndreu, President I Ansambli Artistik "Kuvendi" i Dardhës; dekoruar nga Presidenti i Republikës "Për Shërbime të Veçanta Civile" si edhe nga bashkia Dibër me titullin "Nderi i Kulturës Dibrane".

Lindita Qirinxhiu që prej vitit 2011 punon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, fillimisht si Inspektore në Drejtorinë e Aplimit Tatimor dhe më pas si Inspektore në Drejtorinë e Menaxhimit dhe Analizës së Riskut. Ka punuar si pedagoge me kohë të pjesëshme pranë Universitetit Marin Barleti dhe që përveç punës zyrtare, është mjaft aktive edhe në veprimtari të ndryshme sociale.

Gazmend Agaj, me një eksperiencë gati 30 vjeçare në fushën e gazetarisë, si gazetar në Radio Tirana në realizimin e programeve artistike dhe kulturore; Kordinator për medianë në Festivalin e 45 të Këngës në RTSH dhe që prej vitit 2020 është gazetar në Radio Ejani, dhe realizues i programit muzikor Bio Folk. Po ashtu, z. Agaj është angazhuar në fushën e zgjedhjeve si ekspert. Në vitin 2017 ka marrë titullin Ekspert Zgjedhor nga organizata ndërkombëtare ENEMO dhe ka qenë Vëzhgues Ndërkombëtar në proceset zgjedhore në Ukrainë, Kirgizstan, Kazakistan, Gjeorgji, Armeni, Turqi, Kosovë, Poloni, Bullgari, Maqedoni e Veriut. Sot ai merr titullin Ambasador për Paqe.

SHQIPËRIA DHE KOSOVA ME 6000 AMBASADORË PËR PAQE

Sekretari i Përgjithshëm i Federatës së Paqes Universale për Shqipërinë, Gani Kroshi, ndërsa ka uruar pesë ambasadorët e rinj, që iu shtuan numrit 6000 të Ambasadorëve për Paqe në Shqipëri dhe Kosovë, të cilët përfaqësojnë elitën e shoqërisë shqiptare duke përfshirë këtu udhëheqës të sferës politike, akademike, fetare, shoqërisë civile etj., ka bërë të ditur se Federata e Paqes Universale (FPU) është një rrjet global individësh dhe organizatash që i janë përkushtuar ndërtimit të një bote në paqe, bazuar në vlera morale dhe shpirtërore universale dhe se FPU është një OJF me Status të Përgjithshëm pranë Këshillit Social-Ekonomik të OKB-së.

Është vërtetë frymëzues dhe inkurajues numri prej rreth 150.000 Ambasadorë të Paqes që numëro-

(Vijon në faqen 3)



Kryetarja e Bashkisë Bulqizë Festime Mjeshtri ka mirëpritur ftesën e Ambasadorit të Katarit në Shqipëri, Jabor Ali Hussein Al Haëshela Al Dosari, ku shpreha mirënjohjen tonë për mbështetjen e ofruar ndaj Shqipërisë.



Buxheti me pjesmarrje, takimet me grupet e interesit për buxhetin 2024

Në vazhdim të zbatimit të Kalendarit të Konsultimeve Publike për buxhetin 2024, Bashkia Bulqizë organizoi disa takime me komunitetet e njësive ad-

ministrative për të diskutuar prioritetet kryesore të buxhetit të kësaj bashkie.

Në këto takime, morën pjesë përfaqësues të komunitetit, institucioneve arsimore, këshilltarë të Këshillit Bashkiak dhe përfaqësues të sektorit të biznesit. "Diskutuan hollësisht linjat e buxhetit, përfshirë investimet publike, përmirësimin e infrastrukturës rrugore, rritjen e cilësisë në arsim, shërbimin e ujësjellësit, etj.

Procesi i konsultimeve publike është një hap i rëndësishëm për të siguruar që buxheti i vitit 2024 të përmbushë nevojat dhe pritshmëritë e komunitetit. Gjithashtu, ky angazhim i përbashkët synon të sigurojë transparencën dhe përfshirjen e të gjithë palëve në hartimin e buxhetit local" pohon kryetarja e Bashkisë Festime Mjeshtri. Në këto takime u parashtruan planet dhe projektet që ka parashikuar, ku pas shumë vitesh Bulqiza do të jetë në fokus të investimeve dhe përmirësimeve.

Bashkia e Bulqizës, bashkëpunim me Ambasadorin e Katarit në Shqipëri



Kryetarja e Bashkisë Bulqizë Festime Mjeshtri ka mirëpritur ftesën e Ambasadorit të Katarit në Shqipëri, Jabor Ali Hussein Al Haëshela Al Dosari, ku shpreha mirënjohjen tonë për mbështetjen e ofruar ndaj Shqipërisë.

Gjatë këtij takimi u diskutua mundësitë e bashkëpunimit në zbatimin e projekteve zhvillimore në zonën e Bulqizës. Në veçanti, u theksua gadishmëria dhe angazhimi i strukturave vendore për të kontribuar në realizimin e ndërhyrjeve në fushat prioritare si: shëndetësi, mbrojtje sociale, arsim, turizëm etj.

Nisur nga interesi dypalësh dhe dëshira e mirë për të kontribuar në territorin e Bashkisë Bulqizë, u la e hapur mundësinë e një takimi të afërt për të sjellë në tryezë projekte konkrete për financim.

Bashkëpunim ndërinstytucional për menaxhimin e situatave të ndryshme

Në mbledhjen e radhës të Këshillit për Sigurinë Publike në Bashkinë Bulqizë u diskutuan disa çështje me rëndësi të lidhura me bashkëpunimin ndërinstytucional për menaxhimin e situatave të ndryshme, duke përfshirë pasojat e reshjeve të shiut dhe borës. U theksua rëndësia e përgatitjes së ekipit lokal dhe përfshirjes së kapaciteteve për reagim të shpejtë në raste emergjencash.

Një tjetër pikë diskutimi ishte pastrimi i çdo lagjeje në fund të muajit. U përcaktua një plan veprimi për të siguruar përfshirjen më të madhe të komunitetit në këtë proces dhe për të garantuar një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm për të gjithë qytetarët. Gjatë takimit, u trajtuan edhe çështjet e dhunës në familje, ku u fol për masat e mundshme parandaluese, duke përfshirë sensibilizimin e komunitetit, trajnimin e vazhdueshëm të personelit të përfshirë në ndihmë, dhe ofrimin e mbështetjes për viktimat e dhunës nëpërmjet shërbimeve sociale dhe ligjore. Në përfundim të takimit u konkludua për nevojën e rishikimit të planeve të përbashkëta të veprimit për të adresuar çështjet e diskutuara dhe për të përmirësuar sigurinë publike në Bulqizë.



Kryebashkiakja Festime Mjeshtri inaguroi Qendrën Komunitare Multifunktionale



Kryebashkiakja Znj. Festime Mjeshtri inaguroi më 31 tetor 2023 Qendrën Komunitare Multifunktionale. Nga janari i vitit 2023, Terre des hommes - Albania dhe UNICEF Albania me mbështetjen financiare të qeverisë Britanike (British Embassy Tirana) po implementojnë projektin "Ngritja e rezistencës parandaluese dhe shërbimet e reagimit

të menjëhershëm për fëmijët viktimë të trafikimit dhe formave të rënda të dhunës" në bashkinë Bulqizë.

Qëllimi i këtij projekti është të përmirësojë qasjen në shërbimet sociale komunitare për të parandaluar dhe ofruar shërbime mbrojtëse për viktimat potenciale të trafikimit. Kjo përfshin ofrimin e masave parandaluese për komunitetet në rrezik, me një vëmendje të veçantë të rinjtë dhe popullsia e pafavorizuar.



BUKUROSH KOÇI, AMBASADOR I PAQES

(Vijonë nga faqja 2)

hen deri tani në botë. Në Shqipëri, Kosovë e Republika e Maqedonisë së Veriut, ndër 6000 Ambasadorë të Paqes, këtë titull e mbajnë edhe: Presidenti Rexhep Meidani, Presidenti Alfred Moisiu, Presidenti Fatmir Sejdiu, Presidentja Atifete Jahjaga, Kryeparlamentari Skënder Gjinushi, Kryeparlamentari Namik Dokle, Kryeparlamentari Jakup Krasniqi, Kryeparlamentari Talat Xhaferi, Kryeministri Vilson Ahmeti, Kryeministri Pandeli Majko, Kryeministri Bajram Kosumi, Kryeministri Ramush Haradinaj, si dhe Kryeministri Albin Kurti; prof. dr. Selami Xhepa, prof. asoc. Ali Tonuzi, prof. dr. Alma Cani, etj., si dhe artistët e popullit Margarita Xhepa, Tinka Kurti e Reshat Arbana, "Mjeshtri i Madh" dhe "Qytetari Nderi" i Qarkut Dibër Muharrem Gjoka, njëherësh President i Ansambllit Artistik Artistik "Hazis Ndreu" - "Nderi i Kombit", që ka fituar disa çmime të para e trofe në festivale kombëtare e

ndërkombëtare, si në Turqi, Ulqin, Strugë e Prishtinë, si dhe dhjetëra personalitete të letrave e publicistikës.

Duke konfirmuar mbështetjen dhe promovimin e punës së Kombeve të Bashkuara, si dhe arritjen e Objektivave të Mijëvjeçarit për Zhvillim, z. Rroshi bëri të ditur se "Titulli Ambasador për Paqe u jepet atyre individëve, jeta e të cilëve mishëron parimin e të jetuarit për hir të të tjerëve dhe që i përkushtohen praktikave që promovojnë vlera morale universale, familjen e fortë e të qëndrueshme, bashkëpunimin ndërfaqetarak dhe ndëretnik, harmoninë ndërkombëtare, rinovimin e Kombeve të Bashkuara, median e përgjegjshme dhe vendosjen e një kulture të paqes. Duke kapërcyer kufijtë raciale, fetare, kombëtare dhe etnike ambasadorët për paqen kontribuojnë në përmbushjen e shpresës së të gjitha kohërave - një bote të bashkuar në paqe ku dimensionet fizike dhe shpirtërore të jetës janë në harmoni", tha ndër të tjera z. Rroshi.

• Bukurosh Koçi, kontributori i filmit “...E nderit është nëntoka e Bulqizës...”, lindur e rritur në Bulqizë, pasurues nga profesioni, ka ngritur në këmbë një korpus fabrikash dhe është në të vërtetë prodhuesi kryesor i koncentratit të kromit në vend

reportazh

Le ta quaj: 36 orë në BULQIZË

MARTIN CUKALLA

(vijon nga fq. 1)

Politikanët, eh! politikanët! Nga kryeministri e të gjithë pas tij, nuk lenë rast pa theksuar zhvillimet turistike të vendit, kurse për industrinë nxjerrëse që jep më të shumtën e vlerës së eksporteve të vitit, nuk gjejnë shteg në errësirë për të dalë në dritë e firmosin Statusin i Minorit, a të njohin e zgjidhin problemet e mëdha të subjekteve të prodhimit aty ku punohet! Nuk mund të them që çka shohim e dëgjojmë është “qeverisje e punëve të vendit”, më saktë do ta quaja “qeverisje elektorale e njerëzve”....

2.

Ora 8. Nga Tirana nisemi grup. “Për një orë do jemi në Bulqizë!”, dëgjoj zërin pas meje.

Është Bukurosh Koçi, kontributori i filmit, lindur e rritur në Bulqizë, pasurues nga profesioni, që ka ngritur në këmbë një korpus fabrikash dhe është në të vërtetë prodhuesi kryesor i koncentratit të kromit në vend.



Nuk më besohet. Me makinë të mirë dhe tre orë ishin pak të përshkoje aksin Tiranë-Laç-Shkopet-Burrel për të mbërritur Bulqizën. Rrugë e vjetër tanimë, e harruar si koha e ikur! Lamë pas periferinë kodrinore të Tiranës të urbanizuar rrëmujë e që nuk përfaqëson as fshat as qytet. Mbrapa mbeten dhe disa gryka troniditëse që ndajnë më dysh vargmalin Dajt-Krujë dhe një gurorë famëkeqe të braktisur dhe futemi përtej Dajtit, në terrenet emocionuese ku lëviz Rruga e Arbërit. Rruga e Arbërit, rruga e Arbërit...Nuk mund të mos bie në mendime tek dëgjoj këtë emër. E çthurur dhe çoroditëse siç ka qenë, e shfromuar dhe e përçarë siç është, politika ka ngadalësuar ritmet e zhvillimit ekonomik të vendit edhe pse premisat kanë qenë vlerësuar. Kjo gjendje nuk mundet të shpjerë në normalitetet përparimi pa u vetëkoriguar në themel!

Situata është ngurtësuar edhe në historikun komiko-tragjik të Rrugës së Arbërit, e cila si gjeografi është thjesht segment i Koridorit 8, një arter strategjik i lidhjes Lindje-Perëndim i përcaktuar kështu qysh në vitin e largët 1982 nga presidenti ameri-



kan i asaj kohe. Rruga e Arbërit, për paaftësi të politikës tonë, u tjetërsua duke nxjerrë drejtimin për në Qafë Thanë objekt të Koridorit 8(?!!) çka ishte interesi gjeostrategjik i fqinjëve. Rrugës së projektuar të Arbërit u ul standerti dhe u zvarrit pa cak ndërtimi. Ky objekt po konsumon burime financiare shtesë pas shtese për të cilat nxirret si justifikim problematika gjeologjike.

I njëjti pretekst u shfrytëzua për të shmangur përgjegjësitë politike e penale edhe në rastin e tunelit të Kalimashit.

Në të vërtetë përgjegjësia është e qeverisjeve që, në interes të përfitimave dhe përfituesve privatë, kanë prishur skemën studim: projektim: ndërtim dhe institucionet përkatëse të zbatimit e të ligjëshmërisë.

Parimi i pagesave të investimeve shtetërore mbi bazën e punës së kryer, është i mangët në rast se puna e kryer nuk mbështetet në një studim të thellë gjeologjik e në një projekt teknik të asaj që planifikohet të bëhet.

Kjo shturje ligjore dhe realiteti, ka shpër në rritjen e shpenzimeve buxhetore për hapjen e tunelit në Kalimash!

Mungesa e studimit bëri që të rrëshqasin disa qindra metra nga tuneli i Murrizit, mungesa e projektit teknik të zbatimit bëri të ngecë në argjilat që fryhen përparimi i ballit të tunelit dhe të shtyhet e të shtyhet afti i vënies në punë...

I lë mënjanë mendimet dhe shijoj urat fantastike që lidhin terene të aksidentuara në luginën e lumit të Klosit, pamjet e njohura e mbresëlënëse të luginës së bukur të Plani të Bardhë dhe mbritjen aq të shpejtë në atë çudinë e erërave me emrin Qafa e Buallit!

3.

Tuneli i Qafë Buallit hap e mbyll sytë është dhe vështrimi na përhapet mbi Bulqizë: lugina me qytetin në të dy anët e saj, fshatrat njeri pas tjetrit, malet e veshur në gjelbërim pyjesh e shkëmbinjsh! Dëborë mungon. Diku është formuar një liqen, i ri ky liqen dhe natyra e ka krijuar për të bërë të dukshëm gabimet njerëzore!

Në faqen veriore të malit që mban në shpinë liqejt e Balgajit, duket një rrugë që lidh majën me asgjënë, sikur të jetë e varur rruga; poshtë saj shpatet e veshura me pyje. Është dora e të fortëve që tentoi të grabiste pyjet aty poshtë!, -më thonë. U ngritën në këmbë banorët e Vajkalit dhe i përzunë makineritë. Kështu bënë dhe banorët e Dushajt: bllokuan rrugën e përzunë të fortët që kërkonin drurët e pyllit të Malit të Bardhë diku në verilindje të Bulqizës.

Bukur janë zemërimi dhe kundërshtia për të drejtën dhe të vërtetën, më bukur janë zemërimi dhe kundërshtia ndaj të keqes e padrejtësisë kur për çështjet sociale përfshihen bashkësitë e lira njerëzore!...

Bulqizën koha e ndërtoi në dy gjysëm qytete: Qyteti i Ri dhe Qyteti i Vjetër quhen, përballë njeri tjetrit, mbështetur në dy malet përkundrej që krijojnë luginën, i Riu nuk i ka mbushur të 38 vjetët, i Vjetri ka dyfishin e këtyre viteve dhe është çuditërisht më i përtërirë: me një shesh kryesor të shtruar me pllaka guri të bardhë ku nuk lejohen makinat, me



godina të ulëta e të larta që ndahen nga rrugica e drurë të gjelbëruar, me kafene e hotele të cilësisë së mirë, me monumentin e minorit dhe Pallatin e Kulturës...

Ora është 9. Fiks një orë që u nisëm prej Tirane.

Hyj në Pallatin e Kulturës. Këtu kam qëndruar dhe kur erdha së pari në Bulqizë: 3 Janar 1975. Ftohtë. Erë, dëborë dhe akull.

Kafeneja e dikurshme tanimë është një sallë e shndërruar për ekspozita. Kostume popullore, në atë larminë e begatë të ngjyrave të ndezura të harbimit pranveror të natyrës malore, paraqiten bukur të vendosura në njerën anë të sallës. “Tani e kemi bërë!”, më thotë eksperti Pëllumb Dervishi, i cili muaj më parë më shpegoi eksponatet e Muzeut të Minerës ndërtuar në krahun tjetër të godinës. Aty është dhe Jete Mazari, këngëtarja dibrane e grupit artistik të Bulqizës, një zë brilant që çlirohej lirshëm e bukur në këngët popullore të kësaj treve me folklor të rrallë.

Shkojmë në hotel. Godinë e rinovuar në arkitekturë, mermër i ndritshëm dhe bojëra qelibari që të bëjnë të ndjesh efektet e ambienteve të cilësisë së parë.

Në kafenenë e hotelit gjejmë Kryetaren e Bashkisë. Një zonjë e re, tërë gjallëri për detyrën që ka marrë; duket krenare çfarë përfaqëson, e sigurtë në vetvetë dhe ndoshta me ëndrra për ta bërë më të mirë jetesën në këtë qytet të shquar minoritësh.

Grupi i xhirimit shkon në zyrën e saj për një intervistë.

Unë dhe inxhinier Kurt Skara marrim rrugën për në Batër të Martaneshit. Në timon është Ditjoni, djali i mikut tim të ndjerë, Isufit të mirë. Rruga është një skëterrë e vërtetë bërë nga rreshjet dhe mjetet e tonazhit të lartë, ndoshta dhe e lënë pas dore për shumë kohë.

Ecim nëpër një pjerrësirë të trishtuar; përtej duken male të mjergulluar dhe asgjë... si në një shkretëti të heshtur, pa jetë njerëzore. Diku e diku ka sheshe me krom e makineri, pa njeri e pa zhurmë pune janë. Diku e diku ka galeri nga ku janë derdhur stoqe të mëdhenj gurësh, të heshtura e të pa zhurma dhe ato.

I kam parë ndryshe herët e tjera që kam qënë këtyre anëve, por mësoj se puna është zbehur.

Nuk më rrihet mua plakut pa e rrahur shqetësimin me inxhinier Kurtin.

“Nuk ka punime gjollogjike, nuk ka shtesa rezervash të reja kromi! Ato që ishin po pakësohen përditë...”

Dhe të mendosh vrullin me të cilin u ndërtuan këtyre anëve galeri të reja, fabrika të reja pasurimi, sheshe të rinj për përpunimin e kromit.

Pa shërbimin gjeologjik në aktivi-

tet kërkim-zbulimi nuk ka të nesërme minerare!

Politika as e zgjidhi dhe as nuk u mor të aktivizojë interesimin e gjeologjisë shqiptare

për pasuritë e nëntokës tonë, ato që njihen e duhen shtuar dhe ato që nuk njihen e duhen bërë të njohura për të fuqizuar industrinë nxjerrëse! Gjeologët u lanë mënjanë, në fatin e tyre për të mbijetuar, puna e tyre edhe pse me një produkt të shkëlqyer mbi të cilin u mbështet një industrializim i mbarë i vendit, u shumëzua me zero! Dhe aftësitë e tyre të krenueshme, thuajse me zero u shumëzuan...

4.

Kulla Hupi!

Kisha dëgjuar për të, kisha parë dhe një dokumentar për të, por ndryshe është të jesh tek dera e saj; të heqësh këpucët sipas zakonit e të ngjitesh shkallët; të ecësh jashtë nëpër ato ambiente ku bashkëpunimi i njeriut të punës me natyrën zemërgjerë jep fryte mahnitëse!

Një rrugë e ngushtë, shtruar me kujdes me çakull të imtë, përmes kthesash e gjelbërimi drurësh, të shpie tek Kulla Hupi.

Emri “Kulla Hupi” është shkruar

Është Bukurosh Koçi, kontributori i filmit, lindur e rritur në Bulqizë, pasurues nga profesioni, që ka ngritur në këmbë një korpus fabrikash dhe është në të vërtetë prodhuesi kryesor i koncentratit të kromit në vend.



Le ta quaj: 36 orë në BULQIZË

me të bardhë në faqet e dukshme të gurëve të mëdhenj në kthesa a kryqëzime; bukur kjo përzgjedhje për orientim. Makina parkohet në një lirishte me bar ku qëndrojnë dhe shumë të tjera.

Është e ndërtuar lashtë Kulla dhe gjendet në mes drurësh të mëdhenj në faqen e malit gërqelor që ngrihet prej Urës së Qytetit e drejt shpateve të Malit të Bardhë. "Kullën na e la gjyshi amanet e unë e doja. Më janë dashur katër vite punë në minierë për të fituar lekë për të blerë materialet dhe për të kryer këtë punën këtu që të rehabilitohej Kulla, të bëheshin këto terraca e sheshe dhe të rriteshin këto pemë të reja e bari në këtë pjerrësi."

Nuk doja t'i ikja lashtësisë së Kullës! Që i vogël mblidhja sendet e vjetra që hidheshin të lodhura nga përdorimi dhe i sistemoja në nënçatinë e Kullës së Gjyshit.

Doja të shkrija në Një atë lashtësi me nevojat e jetës dhe mundësitë që kemi sot për të jetuar..."

Mua më vjen ndër mend një djalë i Duriçëve, që, në pyllin e vet buzë liqenit sipër në mal, dëshironte të ndërtonte objektin "Hani Duriçi"; diku aty ku kishte qenë një trung i stërthatë me diametër tre metër, aty, ku larg syrit të të huajve e hafijeve, në kohët e para mblidheshin burrat për të drekuar e për të kuvenduar bëmat. Ai, djali i Duriçëve që e kishte ruajtur pyllin me të shtëna topi të marrë nga depot në v. '97, ëndërronte një ndërtesë që dilte nga shkëmbi e nderej deri mbi liqen prej ku nisej një shteg i rrëpirtë për kalorësit që donin të ngjiteshin në Dhoks për të kundruar pyjet e pamata e kullotat verore e liqenet e shumtë të asaj rrafshine që shtrihet deri në Malin e Tërnovës së Madhe....

Mu kujtua dhe çuni i Ketave, i shquari Jonni Ismaili që braktisi rininë e vet të hershme për të realizuar një ëndërr. "Ec e vrapol!", -thotë vete Ai. E kish nisur fëmijë stërvitjen. Rraskapitej tërë ditën e lume duke gjuajtur me grushtat e një vogëllani një thes me rërë të mbushur në dampën e fabrikës së pasurimit të kromit dhe dikur, dikur më vonë iku në Gjermani ku së pari punoi pjatolarës; duroi veç të tjerash dhe meritë pse ishte i shpejtë e korrekt në punë?! Pas punës së mundimshme stërvitej në kickbox. Mandej, krenar që ishte nga Bulqiza, iu fut konkurimit dhe e fitoi sfidën e rëndë: u shpall kampion i Gjermanisë, në vitet 2011 dhe 2012 por edhe kampion bote.

Jeta bën të vetën, por kurajo nuk mposhet kur ushqehet nga një mendje e shëndoshë! Jonni Ismail Keta ka një shkollë kickboxi në Mynih dhe një qendër moderne të stërvitjes fizike. Nuk e ka haruar vendlindjen: Ka ndërtuar aty Kullën Keta. Një rrugë e asfaltuar që pjerrësohet butë e bukur shpatit të malësise veriore të Bulqizës, të shpie tek ajo...

Një drekë e gatuar prej prodhimeve të veta dhe vera e vendit na shijojnë këtu në Kullën Hupi; kundrojmë ambientet dhe mbrëmjen që po bie ngadalë dhe e freskët; i afrohem një zjarri të ndezur jashtë dhe bisedojmë me disa të huaj që kanë bujtur aty përpara nesh.

Duke këmbyer kujtime me burra të fisit Hupi me të cilët kam punuar dikur në minierë, për qejf, rrotulloj një pjekës kafeje mbi prushin e një oxhaku, siç kam parë ta bënë dhe pleqtë e dikurshëm; në të vërtetë e rrotulloja gabim: përkundër!

Operatori Xhemal Reçi nuk ka kohë të shijojë bukuritë e pamjeve dhe ushqimin në Kullën Hupi. Gjithë kohën në lëvizje me aparatin e filmimit në dorë. Më së shumti kineast profesionist prej zemrës e talentit se prej zorit të detyrës. Eshtak e i gjatë, i heshtur, me vështrimin e përqëndruar në objektin që filmon, duket e më zhduket prej syve, në kërkim të këndeve më të përshtatshme të filmimit dhe breza të padukshëm të dritësimit të pamjes që ka radhën për tu fiksuar në kamera.

Tek kthehem në hotel nëpër terrin e natës, më çudit ndriçimi mbresëlënës i dy krahëve të qytetit unik të Bulqizës dhe i shpateve të malit në jug, ku

natyrisht janë sheshet e galerive që ngjiten e ngjiten si të duan të bëhen një me yjet.

5.

Mëngjezi është i freskët.

Unë nisem të shoh ndryshimet e ndodhura në sektorët ku ka filluar së pari shfrytëzimi i kromit në Bulqizë. Të mërzisin grumbujt pambarim të gurëve dhe gropat e hapura nga shëmbjet që shëmtojnë terrenin e janë rreziqe të mundëshme.

E kapërcej atë pamje, iki për nga Almarina. Rruga e shtruar kujdesshëm duket si një shteg nëpër pyllin që ka marrë shtat të plotë.

Në kërkim të një vizatimi ne gur që e kam parë dikur në vitet e para të punës këtyre anëve, vështroj shkëmbinj të që mezi duken.

Ajo pamje që e kam humbur, është si një eksplozion në përfytyrimin e strukturës kromifere të



Bulqizës: Diku në këtë shpat mali, mbi një faqe të një shkëmbi, që kur ishte krijuar, një shilir kromi që rregjistruar si të përfaqësonte në shkallë të vogëluar profilin e trupit të kromit të Bulqizës, me sistemin e rrudhosur të tij e me imtësitë e tjera strukturore të vëndburimit.

E çuditëshme pamja që kam fiksuar prej atëhere! E kam kërkuar përherë kur jam ndodhur këtyre anëve, nuk e kam gjetur më!..

Është koha të vizitohet fabrikën e pasurimit të kromit. Më shoqëron inxhinier Bukurosh Koçi, djali Bulqize, ka qenë përherë pjesëmarrës në fazat e zhvillimit të pasurimit të kromit këtu. Edhe kur u privatizua Bulqiza. I ri në moshë dhe pa ndonjë lidhje me të fortë a të fuqishëm pushteti, mori përsipër një karaktinë (siç ishte katandisur atë kohë ky objekt që nuk tërhoqi fare vëmendjen e blerësit italian të minierës) dhe, me dije e vullnet, bëri këtë objekt që po vizitohet: godina të strukturara për të përballuar dimrat, teknologji që pasurojnë edhe mineralet që dikur hidheshin si mbetje, puntorë të përkushtuar dhe makineri moderne, rregull!

Bukuroshi e ka shumëfishuar domenin e vet në hapsirën e përpunimit të kromit: Ndërtoi një fabrikë të re pasurimi në Kukës, bleu dhe rikonstruktioi objektet e pasurimit të kromit në Gjakovë, ndërtoi miniera të reja etj.

Dhe një risi për të cilën flitet shumë, por që e shoh për herë të parë në industrinë tona të kohës: Taracat e të gjitha godinave të fabrikës së pasurimit janë mbuluar me panele diellore si burime të energjisë elektrike për makineritë poshtë tyre...

6.

Po epilogu ?

Duke kërkuar diçka si përfundim të qëndrimit prej 36 orësh në Bulqizë, nuk mund të mos theksoj:

Disa jetojnë duke shtyrë ditët njëra pas tjetrës; disa rropaten për të përtërirë praninë e tyre në muajin tjetër e në brezin tjetër; disa venë themele, projektojnë e ndërtojnë ndryshime të qenësishme të peisazhit ku rritet e lulëzon jeta e komunitetit...!

E qenësishme është bashkëpunimi me natyrën; të ndërtohet një gjë e të mos priset diçka është e pamundur!

Janë ndërtuar minierat e fabrikat e pasurimit në Bulqizë dhe ja aty diku është çfaqur një liqen: toka në perëndim të Qytetit të Vjetër është ulur e po ulet; janë dërmuar godina e rrugë; dëgjohet zbehtë një alarm "po shteren ca burime ujore!"

Pse? Pse?

Duhet një përgjigje!

Përgjymja e përjetëshme e thellësive shkëmbore është prishur. Masat shkëmbore janë vënë në lëvizje në zemrën e tyre. Ujrat nëntokësore kanë ndrruar shtratit dhe rrjedhin në shtigje të rinj.

Këto duhen njohur e duhen konsideruar... Siç duhen konsideruar vatrat më të bukura të turizmit të zonës: Almarina, Liqenet e Dhoksit e liqenet e Balgjajt që ngjajnë me liqenet e Lurës sepse kanë të njejtin shtrat: masivin shkëmbor magmatik të gjelbër dhe i kanë krijuar të njejtat duar si shtrat të vet: akullnajat.

Këtu nuk mjaftojnë fjalimet e shtetarëve, por dora e shtetit për të ngritur infrastrukturën regjionale: rrjetin rrugor të asfaltuar, rrjetin e energjisë elektrike, rrjetin e ujit të pijshëm dhe atë të mbledhjes së mbetjeve të përditëshme të jetës njerëzore... Kullat aty i ndërtojnë banorët! Dhe shtigjet për këmbësorët a kalorësit!

Është momenti historik kur duhet të bëhet një shumatore dhe bilanc i të gjitha fijeve që ndërtojnë Shqipërinë e sotme, të shihen përputhshmëritë e diskordancat e krijuara dhe të lejohen, stimulohen e ndërtohen ardhmëritë e reja që plotësojnë kuadrin evropian të objektivit kombëtar sipas normave të planifikimit të teritorit dhe jo në shtigjet e autarkizmit.

Është mbrëmje kur hymjë në periferitë verilindore të Tiranës.

Sidoqoftë rrugëtimi në vend tjetër, kthimi në shtëpi është i këndshëm dhe të jep një ngrohtësi e qetësi të çuditëshme shpirtërore.

Provoj ato ndjenja që kam pasë sa herë jam kthyer prej jashtë në Rinas e në shtëpi. Mu dukën të ndryshkura e të vobekta grumbujt e pa formë të banesave të periferisë, rrugët e papastuara dhe makinat e pluhurosura parkuar andej e këndej, ndriçimi...

Freskinë diellore dhe ajrin e shëndetshëm i kisha lënë mbrapa, diku në atë që quhet Bulqizë!

SHOQATA "BULQIZA"
Atdhetare kulturore
FUSHA E VEPRIMTARISË

2. Të punojë për të siguruar pjesmarrje sa më dinjitoze në jetën shoqërore, në proceset vendimarrëse në mbrojtje të paqës, demokracisë e të drejtave të njeriut.

Vështrimi analitik historik i shërbimit stomatologjik, vepër me vlera shkencore e Prof. as. Nazmi Koçi

Stomatologjia në Shqipëri nga lashtësia deri në ditët tona

HALIL RAMA-MJESHTËR I MADH

“Një libër diturie, një libër shërbimi, një libër përvojë, një libër në shërbim universitar”. Qoftë dhe vetëm nga ky vlerësim i akademik prof. dr. Shaban Sinanit, gjithkush do të bëhej kureshtar për të lexuar dy vëllimet e veprës voluminoze (në dy libra) të Prof. as. Nazmi Koçi “Stomatologjia në Shqipëri nga lashtësia deri në ditët tona” (vështrim historik). Sepse siç shkruan akademik i mirënjohur Sinani në parathënien e vëllimit të parë të kësaj veprë: “Stomatologjia në Shqipëri (nga lashtësia deri në ditët tona) është strukturuar sipas një mënyre bashkëkohore, duke ndërthurur metodologjikisht parimin e periudhimit (kronologjisë) dhe parimin tematologjik. Thënë më shkurt, sistematik e tematik njëherësh, shenjë tjetër paralajmëruese se në vijim do të kemi rastin të takohemi me njeriun e dijes dhe jo thejst të kujtimeve profesionale, të cilat, sado të bukura të jenë, kanë për shoqërim atë pyetje djallëzore të thënies së të vërtetës”.

Po. Këtë rast e patën qindra profesionistë dhe jo të profilit të Dr. Koçi në promovimin e veprës së tij, organizuar nga Akademia e Shkencëve të RSH, ku personalitete të fushës si prof. dr. Fejzi Keraj, prof. as. Erda Qorri, Prof. dr. Pavli Kongo, rektor i Albania University, Brunilda Koçi (redaktore shkencore), etj, vlerësuan veç të tjerash pasionin, vizionin dhe kapacitetin intelektual e dimensionin njerëzor të dr. Nazmi Koçi për realizimin e këtij misioni tepër të rëndësishëm kombëtar, në fushën e dentistrisë.

Është vërtetë një vepër studimore shkencore, ku si askush tjetër Prof. as. Nazmi Koçi sjell për lexuesin një historik të shkurtër të stomatologjisë në botë (Lindja dhe zhvillimi i stomatologjisë si shkencë që nga periudha parahistorike deri tek themelimi i universiteteve dhe futja e teksteve dentare.)

Në mënyrë kronologjike, por me argumente shkencore, në vëllimin e parë të kësaj veprë autori na njeht me stomatologjinë shqiptare nga lashtësia deri te shpallja e pavarësisë (1912) dhe në vijim sipas etapave kohore: 1912-1944; 1944-1948; 1948-1993, ku sjell fakte e shembuj referuar mendimeve të specialistit para një shekulli si dhe për organizimin e shërbimit stomatologjik ndër vite.

Prof. as. Erda Qorri, në analizën e saj të hollësishme (në emër të Komisionit të Mjeksisë të Akademisë së Shkencave), ndër të tjera tha se rëndësia e kësaj veprë konsiston në faktin se për herë të parë lexuesit i bëhet e ditur nga ky libër, se dentisti i parë shqiptar është shkoderani Hasan Kaduku, i cili ushtronte këtë profesion që nga viti 1896, ndërsa dentistja e parë ka qenë Theodita Naçi në Tiranë. Po ashtu, – vijoi Prof. as. Erda Qorri, i bëhet e ditur lexuesit se një Federatë e parë shqiptare e dentistëve daton që në vitin 1931, me kryetar elbasanliun Qemal Bobrati, dhe kjo 19 vjet pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, ose 31 vjet më vonë se themelimi i vetë Federatës Botërore dentare.



“Zakonisht thuhet se niveli i zhvillimit të shoqërisë përcaktohet prej kujdesit shëndetësor apo kulturës së shëndetit oral, dhe për këtë, të dhënat e sjella nga autori i kësaj veprë na bëjnë të shohim realitetin e asaj periudhe, e cila me sa duket, bazuar në raporte e botime artikujsh të dentistëve, paraqesin ekspertiza dhe thirrje për shtimin e vëmendjes në këtë aspekt, duke sjellë kështu fakte reale të situatës, ashtu siç ajo ka qenë”, vlerëson prof. Erda Qorri.

Ky produkt studimor shkencor i një rëndësie të veçantë, i vjen lexuesit dhe veçanërisht personelit të klinikave të shumta dentare në Tiranë e rrethe si dhe pedagogëve e studentëve të fakulteteve përkatëse, nëpërmjet një bibliografie mjaftë të pasur dhe konkretisht: 39 tituj bibliografikë të autorëve të mirënjohur botërorë dhe vendas si dhe ligje e vendime që i përkasin fushës, për pjesën e parë; 29 që i përkasin pjesës së dytë të veprës; 34 për pjesën e tretë dhe 391 në pjesën e katërt. Po ashtu, në listën e gjatë të figurave gjejmë jo vetëm babain e dentistrisë Perre Fauchard por edhe poltronin dentar kinez dhe dhjetra klinika dentare të njohura të vendit e botës.

STRUKTURA KOMPOZICIONALE DHE RËNDËSIA E VEPRËS

Pothujse me të njetën strukturë kompozicionale është edhe vëllimi i dytë i kësaj veprë me gjashtë kapituj: Disa veçori të shërbimit stomatologjik shqiptar; Arsimit i lartë mjeksor stomatologjik në Shqipëri; Literatura mjeksore stomatologjike; arkitektet e stomatologjisë shqiptare; Institucionet menaxhuese të Shërbimit Stomatologjik në Shqipëri dhe Stomatologjia sot dhe e ardhmja e saj.

Ndaj dhe me të drejtë prof. dr. Fejzi Keraj e konsideron këtë një libër historik profesional e shkencor me shumë vlera dhe si i tillë duhet të jetë pjesë e programit të studimit për të gjitha fakultetet e stomatologjisë. Kjo sipas tij për faktin se “Vepra në dy vëllime e këtij autori e sjell të plotë portretin e stomatologjisë shqiptare deri në ditët tona; ajo përfaqëson një material studimor e bibliografik me vlera të rralla në literaturën mjeksore shqiptare”.

Vetë autori Prof. as. Dr. Nazmi Koçi pohon se në këtë libër rindertohet historia e fillimeve të stomatologjisë si shërbim me status ligjor, megjithëse kufijtë e periudhimit janë marrë prej historiografisë politike-shtetërore, merr kuptim theksimi i faktit të kalimit prej subjektivitetit profesional në subjektivitetin ligjor, me marrjen e përgjegjësisë nga shteti dhe krijimin e disa kushteve që mundësojnë kalimin prej disiplinave në nëndisiplina.

Prof. Koçi thotë se botimi i Librit u zgjat në kohë për disa arsye.

“Mendimi për ta realizuar këtë punim u publikua në vitin 2018, por puna për realizimin e tij kishte filluar që në vitin 2003, ndërsa në pesë vitet e fundit kam punuar çdo ditë intensivisht, kam fjetur e jam zgjuar me këtë problem. Pati diskutime për shtrirjen kohore të trajtimit, u bënë propozime që punimi të fillonte që nga viti 1944; Pati diskutime për titullin dhe u bënë disa propozime si: Historik, Vështrim historik, Zhvillimi i stomatologjisë etj. Unë e mbrojta në parim argumentin që historia e popullit tonë është shumë e lashtë e nuk fillon me 1944. Preferova të mos bëj një historik klasik për stomatologjinë në Shqipëri, por një portret sa më të plotë të saj”, pohon dr. Koçi. Kjo sipas tij për faktin se “Stomatologjia është e vjetër si shërbim sa vetë njerëzimi, por është e re si shkencë më vete. Ajo ka ecur nëpër shekuj e mijëvjeçarë sëbashku me shkencat tjera. Të dhënat për stomatologjinë duhen kërkuar në dokumentet e shkencave tjera si mjeksia e përgjithëshme, arkeologjia, historia, shkencat e natyrës, antropologjia, në epitafet e varreve, veprat e artit, në folklor etj. Kjo më detyroi të deklaroj para kolegëve në një takim, kur ata u interesuan për ecurinë e punimit, se ‘Në malet e Afrikës ka diamante, por për t’i nxjerrë ata duhet të shembësh malin”.

Po. Prof. as. Dr. Nazmi Koçi, me përvojën, përkushtimin dhe vendosmërinë arriti t’i zbulojë të fshehtat e këtij “mali” për sa i përket zhvillimit të stomatologjisë në shekuj, dekada e vite. Duke kërkuar grumbulloi një material prej dhjetra mijëra faqesh, me preferencë për të mos anashkaluar dokumente e fakte, duke

• **Akademik, prof. dr. SHABAN SINANI:** “Besoje se duke shkruar këtë libër Nazmi koçi, profesor, mjek, njeri i shërbimit, ia ka arritur të realizojë atë që latinët e shprehnin me një idiomë të mirënjohur: *Corona opus finis – t’i vësh veprës kurorë*”

ju dhënë kështu një shans dokumenteve në prag asgjësimi. Dhe këtë e bëri sipas parimit në punën e mjekut: “jepi një shans të jetoje”. Kësaj i sherbeu dhe fakti se kishte njohje të detajuar të mëparshme të problemeve të stomatologjisë dhe kësajsoj arriti të na japë një panoramë, portret të Stomatologjisë, në mos ezauvues, sa më përfaqësues e të plotë.

PAK RADHË PËR AUTORIN DHE VEPRËN E TIJ VOLUMINOZE NË DY VËLLIME ME 1040 FAQE

Prof. as. Nazmi Koçi kishte të gjithë staturën e duhur për këtë sipërmarrje të vështirë dhe delikate. Dr. Nazmi Koçi që ka lindur në Dibër më 17.04.1947, me një karrierë të shkëlqyer profesionale dhe akademike, kishte pasionin, vizionin dhe kapacitetin intelektual për realizimin e këtij misioni tepër të rëndësishëm kombëtar në fushën e dentistrisë.

Dr. Nazmiu, si ish – Shef i Shëndetësisë në Dibër, ish – drejtues i stomatologjisë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe më vonë i asaj të kryeqytetit për disa vite, pedagog në disa shkolla të larta të profilit të stomatologjisë, autor tekstesh e studimesh shkencore, që ka realizuar më shumë se 140 publikime brenda e jashtë vendit, ekspert i arsimit të lartë në këtë fushë pranë Ministrisë së Arsimit dhe ASCAL, kishte njohjen dhe kompetencën për një sipërmarrje të tillë voluminoze. Pra, dr. Nazmi Koçi kishte të gjithë kapacitetet njohëse për këtë shërbim si rrallëkush nga kolegët e profesionit tonë. Ai kishte kohë që kishte filluar të merrej me një punim të tillë dhe kishte botuar disa materiale mbi problemet e organizimit të shërbimit në fushën e stomatologjisë.

Ndaj dhe me të drejtë prof. as. Erda Qorri konkludon se Dr. Nazmi Koçi sjell një libër i cili do t’i shërbejë çdo stomatologu të njohë rrugëtimin e profesionit të zgjedhur. Madje kjo vepër përbën një aset që mund të përdoret nga pedagogët në auditorët e universiteteve për të prezantuar zanalillat e lashta që ka ky profesion në vendin tonë, ashtu sikurse në vendet tjera të botës, pjesë e së cilës kemi qenë dhe jemi edhe ne, si dhe dinamikën e zhvillimit deri në ditët tona.

Në tërësinë e saj, vepra e Prof. as. Nazmi Koçi “Stomatologjia në Shqipëri nga lashtësia deri në ditët tona” (vështrim historik), në dy vëllime me 1040 faqe, (e promovuar para disa ditësh nga Akademia e Shkencave të RSH) përbën një kontribut të çmuar, jo vetëm për dentistrinë shqiptare por edhe më gjerë. Kjo edhe për faktin se deri më sot mungonte një dokument i tillë në arkivat dhe bibliotekat shqiptare.

Falenderim e mirënjohje për të gjithë bulqizakët që u gjendën të gatshëm për strehimin e vëllezërve kosovar të dëbuar nga trojet e tyre në pranverën e vitit 1999.

Mikpritja e kosovarëve, ura që e mban të bashkuar kombin shqiptar

24 vite me parë, mijëra shqiptarë të Kosovës të përndjekur nga ushtritë serbe, kaluan kufirin për në Shqipëri, në vendin që e cilësonin si atdheun e dytë. Shqiptarët hapën dyert për t'i mirëpritur dhe banorët e Kukësit ishin të parët dhe më pas të gjithë banorët e Shqipërisë hapën dyert me zemër e dashuri vëllazërore. Populli që ka vuajtur është më i gatshëm që të ndihmojë të tjerët. Mikpritja e një populli që kërkon liri, ishte faktori i rëndësishëm i forcimit të vëllazërimit edhe pse kufiri shekullor na ndau fizikisht, shpirtrat e vëllezërve mbetën të ndezur për humanizëm.

Bulqizakët u treguan të gatshëm për mikpritjen e familjeve kosovare që erdhën në Bulqizë dhe shkuan pranë qendrave të strehimit dhe i morën në shtëpitë e tyre, burra, gra e fëmijë, duke i bashkuar me familjet e tyre në sofër edhe pse jetonin edhe vetë në hapsira e kushte minimale.

Mikpritja e kosovarëve mbeti ura që e mban të bashkuar kombin shqiptar në jetë të jetëve.

Më së miri e dëshmon këtë Neki Makshana, i cili shkruan në një status të tij në facebook se :



“Ne si familje s’mujm ti harrojm ditët e vështira të viteve 1998-99 të Luftës në Kosovë kur familja Duriçi, veçanarisht Qemal Duriçi hapi dyert e shpisë, kur shumë familje u ndihmuan nga kjo familje; kur edhe ne ishim në mesin e këtyre familjeve.

Respekt pa fund për kontributin e dhënë, për djemt e “Dervish”Ismajlit”.

PROFILI

Inxhinieri bulqizak, drejtues projektsh në Gjermani dhe Zvicër

Emiljano Hoxha, inxhinieri bulqizak i talentuar drejtues projektsh në kompanitë më të njohura në Gjermani dhe Zvicër



EMILJANO HOXHA



gjatësinë 3604 ml, është me një tubë dhe ka dy korsi lëvizje. që mund të përshkohet për 2minuta e 45 sekonda me shpejtësinë e lejuar 80 km/orë.

Me dëshirën për të marrë pjesë në sa më shumë projekte ndërkombëtare në fushën e tij, ai u vendos në Zyrih të Zvicrës.

Që nga nëntori i vitit të kaluar, Emiljano Hoxha, punon si drejtues projektsh në sektorin “Mobile Mapping”, në një nga Kompanitë më të njohura në Zvicër, “Terra Vermeaange” AG, punë e cila konsiston në dixhitalizimin e infrastrukturës rrugore si dhe në aplikimin e inteligjencës artificiale.

Përveç angazhimit të tij profesional, ai vazhdimisht është angazhuar dhe ka kontribuar në bartjen dhe përçimin e gjuhës, kulturës dhe traditave shqiptare në brezat e ardhshëm. Gjatë qëndrimit të tij në Gjermani, ai ka kontribuar në shoqata shqiptare, të cilat janë marrë me mësimin e gjuhës, kulturës dhe historisë shqiptare. Të njëjtën gjë, Emiljano do ta vazhdojë dhe në Konfederatën e Zvicër, ku ka qindra e mijëra shqiptarë.

Ai po ashtu është pjesë e Shoqatës së Inxhinierëve Shqiptarë në Zvicër (AES), shoqatë profesionale, ku në mesin e saj bëjnë pjesë arkitektët dhe inxhinierët me të shquar shqiptarë në Zvicër.

(Marrë nga postimi: Shqiptarët në Zvicër)

Emiljano Hoxha, ka lindur në qytetin Bulqizë, ka kryer shkollën e mesme po në vendlindje, studimet bachelor në Universitetin Politeknik të Tiranës, dega “Inxhinieri Gjeoinformatike”. Pas përfundimit të studimeve bachelor ai punoi si Inxhinier Gjeodet në Minierën e Kromit Bulqizë, ku kanë punuar edhe babai e shumë shokë e farefis i tij.

Me ambicien për të përfituar një përvojë evropiane, Emiljano vazh-

doi Masterin në Gjermani, në “Karlsruhe Institut für Technologie” në

degën “Gjeodezi dhe Gjeoinformatike”. Më pas punoi si inxhinier Gjeodet në ndërtimin e

tuneleve, ku nga ana gjeodezike drejtoi punimet në tunelin rrugor të tretin më të madh në Gjermani (Kramertunnel), i ndodhur në Bayern. Kramer tunnel gjendet në Bayern, Gjermani segment në autobandin A95. Ka nisur hapja në vitin 2010 e është përfunduar më 2017. Ka

SHOQATA "BULQIZA" Atdhetare kulturore FUSHA E VEPRIMTARISË

4. Të evidentoi e promovojë përmirësimin e vazhdueshëm të resurseve ekologjike dhe turistike e të burimeve natyrore të Bulqizës e krahinave të saj.

SHOQATA "BULQIZA" Atdhetare kulturore FUSHA E VEPRIMTARISË

3. Të evidentojë e promovojë e vlerat e trashëgimisë njerëzore, etno-kulturore, historike dhe përvojat më të shquara të veprimtarëve, të kryera në dobi të atdheut e të krahinave e ishtrave të Bulqizës për mbrojtjen dhe zhvillimin në fusha të ndryshme të drejtimit, edukimit, zhvillimit, shkencës, kulturës, zejtarisë, sportit, artit, etj.

Korpusi i veprave të tij renditet në kohë për të ardhur tek botimi më i fundit me publicistikë letrare "Të fitosh titullin Njeri"

PROMOVIMI

Dërgesat e Halil Ramës në "panairin" e vlerave

PROF. DR. GAFUR MUKA

24 dërgesa të Halil Ramës janë vendosur tashme në stendat e "panairit" të vlerave. Si publicist e si shkrimtar Halil Rama rend e mbledh informacion, vleron e gjykon ngjarje e ndodhi, formulon ide e jep mesazhe, vizaton portete e kompozon tablo aktuale e historike, të kondensuara në aksion e të rrafshuara në përmbajtje, ku lexuesi gjithmonë rrethohet nga një mjedis dinamik me narrative të qartë e të qetë, për të përjetuar gjithëçfarë autori kërkon të përcjellë tek ai. Nuk pretendoj se jam një njohës i tejetejshëm i krijimtarisë së Halil Ramës por, në gjithë çfarë kam lexuar- filluar me artikujt e tij në shtypin e përditshëm apo atë periodik e vazhduar me botimet si libra të veçantë të krijimtarisë së tij- gjej krijuesin e angazhuar, gjithonë në kërkim, gjithmonë të gatshëm për të hedhur në letër atë që i dikton njohja e tij me material jetësor e historik dhe frymëzimi, i mbarësuar më së pari me dashuri njerzore dhe i shprehur me mjeshtëri të veçantë. Këto përfundime nxirren duke lexuar monografitë letrare të tij për Dine Hoxhën e Muharrem Xhedikun, Rrahman Përlakun, Liri Belishovën, Bajram Ndreun, Lutfi Ndreun, Skënder Calën etj. Me spektër të gjerë pasqyrimi portretesh e ngjarjesh, me analiza bindëse e reflektive variacionale janë shkruar "Fundi i Rugës së vetme", "Testamenti i atdhedashurisë", "Memoria historike e kombit", "Në panteonin e vlerave" etj. Një vend të veçantë në krijimtarinë e Halil Ramës zë libri kushtuar vendlindjes së tij "MUHURRI-Histori dhe personalitetet". I gjithë ky korpus veprash renditet në kohë për të ardhur tek botimi më i fundit me publicistikë letrare "Të fitosh titullin Njeri". Pa e lexuar akoma librin, autori të intrigon me titullin dhe të tundon fort për ta lexuar. "Të fitosh titullin Njeri"...nuk di pse më erdhi në mendje një tregim nga pjesët e leximeve në tekstet shkollore, ku flitej për marrdhëniet e një babai me të birin e tij. Babai ish i moshuar ndërsa i biri ishte i pasjellshëm, rrugaç, agresiv e mizor. Babai përpiquej ta sillte të birin në rrugë të mbarë, por ai e përkeqësonte sjelljen e tij nga dita në ditë sa i ati, zemërpasur i thonte "ti nuk ke për t'u bërë kurrë njeri". Dhe erdhi një moment kur djali e braktisi të atin. Fati e çoi në frontin e luftës, atje ku gjithë karakteri i tij i deformuar i hyri në punë. Duke luftuar si egërsirë, duke kryer mizori e duke mos kursyer kërkënd, pleq gra e fëmijë, ai arriti të fitonte beteja dhe ta gradohej, derisa një ditë u shpall mbret. Tashmë si mbret ai mendonte se e fitoi betejën edhe ndaj të atit. Kështu një ditë porositi ushtarët e tij të shkonin e ta gjenin plakun e t'ia sillnin atij të lidhur. Ushtarët e zbatuan urdhërin e mbretit dhe plakun përfundoi i lidhur këmbë e duar përpara frontit të të birit. Nuk më njuh kush jam- foli mbreti. Jo iu përgjigj plakun. Unë jam yt bir-tha mbreti dhe vazhdoi: jam ai



• Nuk mund të lihej jashtë "Të meritosh titullin njeri" as historia e zhvillimeve shumëvjeçare në minierën e kromit Bulqizë. Ky rajon dhe banorët e tij kanë fytyrë e zë tashmë kudo në botë. Në përfocim të këtij zëri, në qartësim të portretit dhe kontributit të Bulqizës autori ndalet dhe pasqyron në libër vlerat e një filmi, pikërisht të dokumentarit të Ylli Pepos "...E nderit është nënëtoka e Bulqizës..." Pasi e lexon këtë reportazh thua me plot gojë: vërtet Bulqiza e meriton titullin "njeri" sepse ajo, si një gjallesë, ka pulsuar në gjithë ato vite duke prodhuar edhe krom edhe qytetërim e, për fat të keq, pak, shumë pak mirëqenje

që ti thojë nuk ke për tu bërë kurrë njeri. Ja tani unë jam mbret. Po, mor po, mbret je bërë por njeri nuk je bërë dhe as ke për t'u bërë-tha plakun.

Tek "Të fitosh titullin njeri" e Halil Ramës, nuk ka as baba të braktisur e të dhunuar as djalë që dhunon e braktis. Tek ky libër, personazhet e pjesës së parë "Ambasadorët të Paqes" janë njerëz me vlera shumë të spikatura profesionale. Ata kanë arritur lartësi të tilla, ku tek vlera profesionale ngjizet natyrshëm e dukshëm vlera njerzore. Dhe këto të dyja sintetizohen në modele për tu marrë shembull. Kështu një ushtarake, Manushaqe Shehu fiton, si e para femër shqiptare, gradën gjeneralmajor dhe mbetet e respektuar tek vartësit e saj. Një mjek si Ali Tonuzi përkushtohet për t'u shërbyer pacientëve dhe fiton gjithë respektin dhe mirnjohjen e tyre. Një stamatolog si Sali Kurti u gjendet pranë pacientëve të tij dhe, me punë të palodhur e profesionalizëm arrin të jetë i suksesshëm në mjekimin e tyre. Personazhe jetësorë, interesantë, të përkushtuar, të suksesshëm dhe të dashur janë po ashtu pianisti Justin Gjata, biznesmeni, President i Ansambllit "Hasis Ndreu", mjeshtri i madh Muharrem Gjoka, historiani dhe kulturologu Hysen Dervishi etj.

Me mjaft interes për lexuesin është portretizimi i familjes Domi nga Cereni i Kalasë së Dodës. 101 të shkolluarit e kësaj familje janë model i punës e përkushtimit kudo ku ata militojnë. Në rrëfimin për Domët autori shpalos cilësi e vrytyte mbresëlënëse brezash duke filluar me Harun Domin, sjellësin e abetareve në një krahinë si Luma, "të cilat u përhapën dorë më dorë dhe u bënë pishtarë drite për shqiptarët ...", duke vazhduar me

djemtë e tij, Shefqetin e Xhemalin më tej me Tajarin, Naimin, Nuriun, Përparimin, Jakupin, Mimosën, Resulin, Mahmudijen, Bashkimin, Dëfrimin, Lavdrimin, Maslien...Ky rrëfim për një familje me vlera të veçanta-shtrirë në 100 vjet kohë- ngjall tek lexuesi respekt e simpati, duke nxitur njëkohësisht dëshirën për të krijuar vlera të tilla familjare në dobi të vetes, të zonës e më tej edhe të vendit.

Personazhet e kësaj pjese të librit, Halil Rama nuk i takon rastësisht. Ata ai i gjen në një moment kur kontributi i tyre shpërblehet me një titull, që mund ta fitosh kur ke merituar më parë titullin njeri, titullin "Ambasador i Paqes".

Në kreun e dytë, autori paraqet tema historike, të cilat atë e kanë inspiruar dhe frymëzuar me vlerat shumëdimensionale të tyre dhe, për këtë arsye e gjen me interes t'ia përcjellë lexuesit të tij. Një inspirim të tillë i ka dhënë libri i studiuesit, gazetarit e shkrimtarit Fatos Daci "Të gjitha rrugët të çojnë në Dibër" i cili, mbështetur në fakte e ngjarje si dhe në përcaktime të historianëve e studiuesve bashkëkohës ka arritur në konkluzionin se "Skënderbeu është nga Sina e Dibrës". Këtë konkluzion e vulosin edhe dokumentat origjinale të arkivave turke të bëra publike kohë e fundit.

Për autorin Halil Rama kjo gjetje është një kontribut për historinë dhe konfirmim i një të vërtete të shumë diskutuar në vite.

Shkrimi për Ahmet Fetah Camin është kronologji e një jete kushtuar mbrotjes së interesave jetike të vendit. Portretizimi që i bën autori e lidh figurën e tij me ngjarje që kërkojnë angazhim patriotik dhe guxim

luftëtari. Ai e vendos besnikërisht Ahmet Camin në mjediset ku ai e kreu aktivitetin e tij, në përgjigje të kërkesave të kohës-Luftën e Parë Botërore dhe Luftën e dytë Botërore. Në të parën ai ishte luftëtar në rradhët e njësisë të kohës kundër forcave serbobullgare ndërsa në të dytën komandant i çetës së Gollobordës në luftën kundër pushtimit fashist të vendit. Halil Rama është kujdesur të na e japë të plotë gjithë aktivitetin e këtij luftëtari të dalë nga gjiri i një familjeje patriotike. Për lexuesin e "Të fitosh titullin njeri" paraqitja e aktivitetit të një atdhetari e luftëtari si Ahmet Cani nuk ka vetëm vlera njohëse por edhe vlera në kuadrin e një edukimi atdhetar të brezave në trojet shqiptare.

Një vend të veçantë në këtë libër ze edhe reportazhi "Dibra e Madhe dhe Diaspora" ku autori shenjon vlera patriotike e atdhetare të kësaj krahine në zhvillimet e veçanta historike të saj. Me penelata të shpejta por domethënëse, Halil Rama paraqet kuadrin e ngjarjeve pikante të krahinës së Dibrës dhe ndalet në respektimin e vlerave historike të saj, posaçërisht në edukimin e brezave me traditat kulturore e patriotike të trevës. Në libër jepet një ngjarje festive si koncerti i madh festiv i 18 gushtit 2023 me një repertor të larmishëm, me këngë, valle e humor ku pjesëmarrja e një numri të madh të dibranëve nga diaspora, por jo vetëm, shijuan artin që buron nga vendlindja e tyre dhe që fytyrëzon tradita që kurrë nuk harrohen.

Nuk mund të lihej jashtë "Të meritosh titullin njeri" as historia e zhvillimeve shumëvjeçare në minierën e kromit Bulqizë. Ky rajon dhe banorët e tij kanë fytyrë e zë tashmë kudo në botë. Në përfocim të këtij zëri, në qartësim të portretit dhe kontributit të Bulqizës autori ndalet dhe pasqyron në libër vlerat e një filmi, pikërisht të dokumentarit të Ylli Pepos "...E nderit është nënëtoka e Bulqizës..." Pasi e lexon këtë reportazh thua me plot gojë: vërtet Bulqiza e meriton titullin "njeri" sepse ajo, si një gjallesë, ka pulsuar në gjithë ato vite duke prodhuar edhe krom edhe qytetërim e, për fat të keq, pak, shumë pak mirëqenje.

Reportazhi "Përkujdesje për moshën e tretë" ka edhe veçanësi tematike edhe veçanësi stilistike. Tema e trajtimit të moshës së tretë është delikate për nga përmbajtja dhe e vështirë për nga realizimi. Por Halil Rama duke marrë shkas nga festa e organizuar më 1 tetor 2023, që njihet si Dita Botërore e të Moshuarve, evidenton aktivitetin e Qendrës Rezidenciale "Strehë dhe Shpresë" në Tiranë nën drejtimin e Shoqatës humanitare "Kuka", ku kalojnë ditët e moshës së tretë 116 të moshuar. Autori nuk ndalet vetëm në pasqyrimin e aktiviteteve të larmishme të kësaj dite por i bën të njohur lexuesit të tij trajtimin e të moshuarve në këtë qendër. Ai gjen që drejtimi që ofron shoqata "Kuka"

(Vijon në faqen 9)



NGA DR. ADRIATIK BALLA

Ymer Keta, i bërë i njohur me botimet e tij sidomos në lemën e historisë, por edhe botime të tjera me karakter kulturor e letrar, ka botuar së fundmi një libër ku përmbledh shënime historike dhe që e ka titulluar “Udhëtim ndër vite në trevat etnike shqiptare të Maqedonisë”. Ky libër vjen si vazhdimësi e botimeve të mëparshme të autorit për shënimet historike që i ka ndërthurur me literaturën historike si dhe përmbledhjet e udhëtimeve të tij në trevat shqiptare të Çamërisë, Kosovës e Malit të Zi. Në këtë libër ne nuk njihemi thjesht me faktet historike të kësaj treve të rëndësishme shqiptare, ku jetojnë sot gati 900 mijë shqiptarë, por nëpërmjet metodave të përzgjedhura me kujdes dhe krahasimet e ndryshme, por edhe faktet e mbledhura direkt nga terreni dhe të vendosura në një kontekst historik të mëparshëm dhe aktual, autori na jep një pasqyrë të qartë të situatës në Maqedoninë e Veriut dhe vendit që kishin e kanë shqiptarët si popullatë autoktone shtetformuese.

Libri, i ardhur me parathënie nga publicisti dhe gazetari i njohur Abdurrahim Ashiku, i përmbledhur në 280 faqe, na dëshmon një përpjekje serioze të autorit, një analizë faktesh mjaft interesante dhe dëshmi të rralla e autentike nga mbledhja e informacionit në kohë të ndryshme, veçmas dhe nga koha aktuale, ku situata e shqiptarëve në Maqedoni duhet të kishte përparuar shumë

“Udhëtim ndër vite në trevat etnike shqiptare të Maqedonisë”

më tepër pas marrëveshjes së Ohrit në vitin 2001. Autori në këtë libër ka dashur me vetëdije që të kujtohet jo thjesht si një studiues, por edhe si një udhëtuës që lë dëshmi nga prekja e fakteve në terren, e në këtë kuadër ai ngjan kështu me Durhamin, Hanin, Nopçën, e shumë figura të tjera të respektuara europiane që kanë lënë gjurmë në trajtimin e çështjes shqiptare në tërësi. Ymer Keta e nis librin me ngjarjet historike nga antikiteti, duke zgjedhur materialet më të vlefshme e të mirëbesueshme dhe vijon pandërprerë deri në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë dhe mbetjen jashtë kufinjve të saj të një pjese të madhe të territorit, përfshi dhe Maqedoninë.

Në këtë fazë të fundit të Perandorisë Osmane dhe sulmit të fqinjëve ballkanikë ndaj trojeve shqiptare, pjesa shqiptare në Maqedoni bëhet arenë luftimesh dhe masakrash të padëgjua, ku popullata shqiptare detyrohet të shpërngulet me forcë drejt Turqisë (kryesisht), ndërkohë që pushtuesi kujdeset të vendosë një pushtet të egër e zaptues me kolonë dhe aparat shtetëror enkas për të asimiluar, shpërngulur, dhunuar e vrrarë shqiptarët.

Në pjesën e dytë të librit, autori na jep një pasqyrë të situatës së sotme në Maqedoninë e Veriut, si shtet i pavarur. Në hapat e parë ky shtet nuk i respektonte aspak të drejtat e shqiptarëve, por pas daljes në skenë të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare dhe luftimeve të ashpra në vitet 2000-2001, Maqedonia detyrohet të ulet në tavolinë dhe të firmosë marrëveshjen e Ohrit që u jep shqiptarëve të drejta vendimmarrëse. Që nga ai moment shumë gjëra kanë ecur përpara, por marrëveshja nuk është zbatuar në përputhje me frymën dhe zotimet e saj.

Ende sot shqiptarët në Maqedoni kanë probleme të identitetit, atyre nuk u jepen të drejta të plota dhe zonat shqiptare nuk marrin investime në proporcion me përqindjen

që kanë në Maqedoni. Duke afuar informacion dokumentar, por edhe prekje nga afër të realitetit, Keta na sjell detaje tronditëse sesi pushteti maqedonas bën çmos t'i lërë shqiptarët qytetarë të dorës së dytë dhe këta të fundit, pra vetë shqiptarët, të përçarë nga politika, nuk arrijnë të përfitojnë dhe të kërkojnë të drejtat që u takojnë.

Në këtë pjesë autori na jep një pasqyrë të qartë të rajoneve shqiptare edhe në planin gjeografik, duke u fokusuar sidomos tek gjeografia e popullsisë dhe vendbanimeve, si Tetovës, Kërçovës, Gostivarit, Kumanovës, Shkupit, Dibrës, Koxhahikut e Rekës, Manastirit, Velesit, Ohrit dhe Strugës, Prilepit, etj. Marrëveshja e Ohrit e 13 shtatorit 2001 solli një hapësirë të re për shqiptarët, por lidhshipi shqiptar në Maqedoni nuk ka ditur të shkojë në të njëjtën vijë me aspiratat e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut.


Ende pushteti sllavo-maqedon i konsideron shqiptarët një minoritet, ndërkohë që shqiptarët në Maqedoni janë komb autokton shtetëformues. Autori, nëpërmjet udhëtimeve të tij, duke bërë krahasime edhe me dokumentet mbi situatën demografike në këtë vend, arrin në konkluzionin që shqiptarët janë 45%. Por ai ndjen keqardhje që nga frika akoma shumë shqiptarë nuk deklarohen të tillë dhe për këtë bën përgjegjës klasën politike shqiptare në Maqedoni. Në këtë botim autori nuk ka lënë jashtë vëmendjes figurat kryesore historike të Maqedonisë shqiptare, nga antikiteti e deri në ditët tona.

Intuita, përvoja, niveli i informacionit, njohja me organizimin administrativ e politik të këtij shteti dhe pozitën e shqiptarëve në këtë shtet, e kanë bërë autorin të na japë një libër me vlerë, që do t'u shërbejë shumë historianëve shqiptarë në të gjitha trojet por edhe lexuesve të shumtë. Në fund, po përcjellim pak rreshta nga parathënia e librit shkruar nga publicisti Abdurrahim Ashiku: “Ai (autori) udhëton, fo-

tografon, vëzhgon, interviston, sjell eksperiencë, analizon e përgjithëson ngjarje dhe dukuri, duke na ofruar mënyra interesante këndvështrimi të problemeve. Autori na sjell fakte të bollshme dhe ka treguar aftësi si një intelektual i vullnetshëm, i përkushtuar për të grumbulluar informacione në shumë drejtime”.

Duket qartë se autori ka sjellë në libër gjëra me vlerë, për një nga trevat shqiptare më në zë, ku ende sot problemet e shqiptarëve si pasojë e persekutimit dhe arrogancës sistematike sllavo-maqedone ndihen jo plotësisht të lirë.

Ky konstatim i autorit merr më shumë vlerë nga intervistat e bëra, vizitat në institucione, analiza e fakteve në nivel politiko-administrativ etj. Ymer Keta mund të konsiderohet madje si autori i parë nga Shqipëria që bën një studim të këtyre përmasave për zonën shqiptare në Maqedoni, me një analizë të hollë të bazuar mbi metodologji të njohura e të besueshme. Ndaj, autorit i urojmë suksese për këtë prurje të re të rëndësishme!



Dërgesat e Halil Ramës në “panairin” e vlerave

(Vijon nga faqa 8)

dhe cilësia e shërbimeve janë vërtet për tu marrë shembull, çfarë do të bënte që mosha e tretë kudo në Shqipëri të kishte cilësi jetesë në standarde të larta humanitare.

Në kreun e tretë “Personalitete të krenarisë kombëtare” portretizohen me vërtetësi figura të tilla që kanë punuar e kanë jetuar për të frymëzuar brezat edhe për sot edhe për nesër. Rrahman Parllaku, një personalitet mjaft i dashur për autorin por edhe me vlera tejet të spikatura për vendin, hap serinë e trajtimit të personaliteteve që përfshihen në këtë pjesë. Në vazhdim jepet portreti i Klodian Tanushit, që humbi jetën si komandant Kontingjenti në misionet ndërkombëtare dhe si përfaqësues i lartë i

ushtrisë sonë në bazën e NATO-s në Letoni, për tu jetësuar përgjithmonë në emrin e një shkolle, ku brezat e nxënësve do thonë me krenari: unë kam mësuar në shkollën “Klodian Tanushi”. Personaliteti i rradhës është prof. Dr. Skënder Kodra, puna dhe arritjet e të cilit, si personalitet dhe faktor i rëndësishëm i komunitetit shqiptar në Amerikë kanë ndikuar në forcimin dhe lartësimin e vazhdueshëm të arsimit dhe edukimit Shqiptar.

Në rradhën e personaliteteve të përfshira në këtë libër janë edhe mjeku Fatos Hoxha, mësuesi në pension Skënder Murrja si dhe intelektual Halit Berisha, portretet e të cilëve në këtë libër, po ashtu janë dhënë me vërtetësi e dashuri nga autori.

Në kreun e fundit janë përfshirë “Shënimet për librat”. Në këtë pjesë Halil Rama analizon dhe

vlerson romanet “Bregua e Prokurorit” të Ahmet Prençit, “Covid 1984” të Namik Dokles, librin “Beteja për 20%” të Ardit Bidos, romanin “Hirushja Pellazge” të Astrit Gjunksit, librin me poezi të Alban Balës “Orët e shtëpisë”, përmbledhjen “Vargje poetike nëpër kohë pakotësie” të Xhevat Limanit, romanin “Djali që urrente Femrat” të Meri Mezin, librin “Kohë e artë për Pehlivanët” të Irfan Dashit, librat e Selman Mëziut, librin monografik të Bibë Kazës dhe librin “Fjalë të arta mbi Shkëlzen” të Moza Reçit-Shehi.

Në përfundim për librin “Të fitosh titullin njeri”, si libri i 24 i autorit Halil Rama, thuhet me plot gojë, që ai zë një vend krejt të veçantë në publicistikën shqiptare dhe është një dërgesë speciale për “panairin” e vlerave krijuese.

POEZI TË ZGJEDHURA



BARIE ÇUPI

Pa dritë jete

Eee moj botë si të t'përpj,
gojën helm, prej gjellës prishur,
s'më je luan e as mi,
barku yt, kazan i fliqur.
Si s'u ngope, mjaft gëlltite,
lotësh prej nëne, lahesh ndër vete,
n'terr të ferrit u shkopsite,
as e vdekur, as shenjë jete..
Më vjen keq për këtë erëbotën,
i panginjshëm zgjohet Njeriu,
"Rrugës Qumështit" syt'ia rropën,
ujin e djallit, kush i pari e piu?

...
hullive të ditës,
dremisim në këmbë me përrallat e sotit,
ca mendimesh avulluar,
ca heshtjesh të kota,
ca si fluturake të rrjepura, e glasin rrugën andej së
fthotit,
ca gërhimash memece,
mërmërisin lajmesh,
nderur telash si sorra.

...
prej syve të mendjes
na ndërtohen pasqyra,
kur dielli bie n'gjumë, del hëna reflekton,
si në "Varreza e Pragës"
fole gjuhësh të fryra,
në padashje,
buzëqeshja ime,
gjoksin cave ua ngushton.

SHOQATA BULQIZA Atdhetare Kulturore

Do të njihet dhe do të shprehet mbi
projektet zhvillimore të Bulqizës ecurinë e
zbatimit të tyre dhe do të bashkëpunojë me
të gjitha institucionet qeveritare e
joqeveritare në arritjen e ritmeve të duhura
bashkëkohore në të gjitha fushat.



BRUNA MUSAI

Cicërimë shpirti..

Cicërimë e shpirtit tim, ku zgjimet janë të ëmbla,
Ajri i pastër i vendit tim, ku më mbushet ç'do bosh-
llëk;
Kudo të jem nëpër botë, të rri pranë teje ma ka ënda,
Zemërthyer rrugëve të botës, emigrim ku shpirti
dhëmb.

Aty ku lutem ç'do ditë, nëpër mëngjesit e mia,
Me buzëqeshjen solare, e rrethuar nga mirësitë;
Aty ku më gjen strehë, çdoherë qetësia...
Mbushur shpirti cicërimë, autokton i vendit tim.

Aty ku ëndra merr krahë, fluturon në galaktikë,
Si shqiponjë dykrenare, udhëton mes dëshirash,
Aty pranë Atdheut tim, ku nuk e njoh fjalën frikë,
Ku zemra pulson e qetë dhe nëpër ditë të vështira.

Mall' i nxehtë gërshëtuar, nëpër vite e dekada,
Zemrën kam të ligështur, të mbytur nga zemërimi,
Kohën dua ta kthej pas, të filloj nga e para,
Aty ku merr fund loti, e zemrën nuk e mbyl trishtimi.

Mall' i madh për atë dhé, atje ku vrapoj i lire,
Për ty i dashur mëmëdhë, që më fal një shpirt të dëlirë,
Pata fatin ta provoj, varferinë dhe pasurinë,
Jo nuk dua te emigroj, më mirë zgjedh këtu të rri.

Ejani zogj shtegëtarë, të shpërndarë nëpër botë...
Ejani në vendin tuaj, shpirti mbushur me qetësi,
Lëreni pas zemërimin, në atë të egër botë,
Autokton i vendit tënd, cicërimë e shpirtit tim.

Dyert e jetës .!

E hapa një derë te vogël, e hyra me vështirësi,
E buzëqesha në fillim dhe pse m'erdhi për të qarë.
Ishte aq e mbushur bota, me mashtrime e hipokrizi,
Enda, eca, e kërkova, dhe pse me një shpirt të vrarë.

E hapa një tjetër derë, aty ishte errësirë,
Nuk ndiçonte as Dielli, as yjet, as Hëna;
Pata frikë nga errësira, dritë lëshonin sytë e m,
Por më duhej të kaloja, që në çastin kur hyra brënda.

E ndalova në një prag, ku ishte një derë e vjetër,
Kisha frikë që ta hapja, ishte mbushur me trillime;
Hyra brenda nëpër mure, zhgarravina si të etur,



SHUIP ELEZI

PËRSE PO NDODHIN, GJITHË KËTO KRIME ?

Nuk po di nga t'ja fillojmë,
Për natë në lajme po dëgjojmë:
Vritet gruaja, vritet fëmija,
Vritet prindi, vritet bija.

Babai vret djalin e tij,
Se pi drogë edhe raki;
Ushtron dhunë përditë ndaj tij,
Shet gjithçka që ka në shtëpi.

Pse po ndodh kjo hata!?
Vritet gruaja, për asgjë!
I kthen armën burri i vet,
Nga xhelozia edhe e vret.

Nuk ka ditë që s'dëgjon,
Për pazare droge, njeriu shkon;
I zanë pritë në fshat, qytet,
Arma mund të vras dhe disa vetë.

Luftë mes bandash sheh kudo,
Dhe shokun e vet e elimino;
Bisnesmenët, n'shënjestër kanë,
Kush s'paguan, me jetë e lanë.

Është vënë jeta në rrezik,
Me dalë në xhade ke frikë.
Ec shoferi me shpejtësi,
Vë përpara, pleq e fëmijë.

Krimin se ndal veç policia,
Me u çu n'këmbë, e gjithë shoqëria!
Duhet pa tjetër, me e luftu,
E shteti ligjin me e forcu!

SHOQATA "BULQIZA" Atdhetare Kulturore FUSHA E VEPRIMTARISË

5. Nisur nga parimet më të larta të
solidaritetit shoqëror, të sensibilizojë
e sinkronizojë potencialet njerëzore
intelektuale për projekte e inisiativa
studimore për sigurimin e zhvillimit
të mëtejshë të Bulqizës.

Poezia, si gjithprani e këndshme

DR. HAJRI MANDRI*


Fillimet e veta poetike, autorja e këtij libri poetik, Dhurata Kola (Kaloshi), i ka që nga fundi i viteve '80, kur në gjimnazin e Bulqizës, aktivizohej në rrethin letrar dhe botonte në shtypin e kohës. Tani pas 3 dekadash kanë ndryshuar shumë gjëra në jetën dhe kulturën e saj letrare. E diplomuar në Universitetin e Tiranës, fakulteti i Drejtësisë, prej dy dekadash jeton në Bruksel dhe punon me dinjitet. Natyrisht, ajo nuk është ngutur të botojë këtë vëllim poetik, por ka vëzhguar me ndjesi të hollë realitete prekëse nga jeta, të cilat, si vatra estetike krijojnë shanse për afirmimin e autores si një profil i veçantë krijues, duke na dhënë një libër me vlera artistike dhe mesazhe të vlefshme bashkëkohore. Fuqia estetike interpretuese e detajeve jetësore që vijnë si prodhim i stimujve mjedisorë kontekstualë, ku ka jetuar dhe përjetuar autorja, japin pasazhe dhe imazhe befasuese që janë në tagrin e poetëve të shquar dhe me përvojë të gjatë. Përparimi i intelektit dëshmohej nga vizioni i qartë mbi shkaqet. Jeta groteske me uljengritje, me ekstreme gëzimesh dhe dëshpërimesh, përbëjnë veçorinë dalluese të lëndës poetike, brenda një përvoje individuale, por që ka aftësi përgjithësuese për t'u bërë e dashur dhe konfidente me lexuesin, në mënyrë të veçantë me emigrantët që kanë provuar zigzaket e jetës, që janë lakuar në spiralet e saj dhe i kanë kundërqëndruar me dinjitet. Dëshiroj të bëj një kroskurrikulë të ilustruar me vargje për të kuptuar më lehtë madhësinë, bukurinë, koncizitetin dhe modestinë e vargjeve të poetes Dhurata Kola Kaloshi.

Karakteristikën etnokulturore të yshtjes serioze të marrëdhënies midis bashkëshortëve, e gjejmë të dhënë me finesë në çastin kur autorja përcjell bashkëshortin në emigracion, duke ditur në atë kohë, që kthimi ishte i papërcaktuar në kohëzgjatjen e tij. Malli, dashuria, vetëpërmbytja, besimi te e nesërmja, respekti reciprok që shenjtëron në mënyrë sakrale lidhjen bashkëshortore, jepet me një vizatim elegant, pa bujë e figura të kërkuara, por që flasin shumë: "Kur ti u nise/ Me copëzat e shpresës në valixhe,/ ne nuk u ndamë me qafje lamtumire./ Pas pikave të shiut,/ E fsheha, të rëndë-trishtimin".

Jeta e vështirë e emigrantit, fillimisht nis me privacione dhe vështirësi të papara dhe të paimagjinueshme. Ndërkohë që autorja, në vendin e origjinës, kishte një përvojë të mjaftueshme intelektuale me fuqi morale, intelektuale dhe konceptuale, e gatshme për t'u integruar në botën e qytetëruar perëndimore. Si njerëz të panjohur në botën e panjohur poetja përshkruan: "Endem kuturu rrugëve të qytetit,/ në mërzë,/ Ndez një cigare, humbem në mendime,/ e vij tek ti./ Duke folur me këmbë e duar,/ për ç'kush e di./ Rendim shpenguar, në apartament,/ të fshihemi të dy."

Me mjeshtëri të rrallë dhe ndjesi të hollë, poetja përdor paralelizmat si dukuri natyrore dhe në përqaasje me dukuritë njerëzore dhe konkretisht, atë që ka të bëjë me kontekstin, me jetën e saj. Pasiguria dhe stresi emigrator ekziston kudo, por imagjinata gjallëronte metabolizmin intelektual të saj. Ja sa bukur dhe në mënyrë koncize shprehet në vargje që krijojnë një vatër estetike ku theksohet mesazhi i kohezionit familjar: "Një gjethe vjeshte u këput e ra,/ dhe unë papritur ndjeva frikë,/ se mos të të humbas,/ se mos më humbet./ Sa shumë kohë i kemi dhënë hamendjes,/ sa pak kemi mbajtur për vete".

Fëmijët janë aveneri i jetës, janë e tashmja dhe e ardhmja për poeten dhe lulëzimi i shpresës, si ëndërr plotësuese e lumturisë së njeriut. Misioni i tyre tashmë është shumë i lartë, shumë motivues, shumë fisnikëruar, por që kanë në krah përkujdesjen prindërore që sëmujet e kohës të mos i prekë: "Ata, rendin drejt betejash për të ndryshuar botën, /ne, në



Dhurata Kola Kaloshi nuk është ngutur të botojë këtë vëllim poetik, por ka vëzhguar me ndjesi të hollë realitete prekëse nga jeta, të cilat, si vatra estetike krijojnë shanse për afirmimin e autores si një profil i veçantë krijues, duke na dhënë një libër me vlera artistike dhe mesazhe të vlefshme bashkëkohore

Dhurata Kola Kaloshi

PRITJA

Po shkojnë ditët si ujt' e Dritit
si vala valës nuk i ngjan,
udha, humbur udhës,
koha, humbur kohës,
po dergjen ndër lisat e ramë.

Klithmat kafshojnë orët,
himnosja ia ka përpi kupën qiellit,
i pashpresë rrëzuar mbi rranjët e shkulluna,
pret, të ngrihen nga varri të vdekurit.

betejë për t'i mbrojtur prej saj./

Ja se si autorja me pak fjalë paraqet shënrrimin e saj psikomoral që i kundërqëndron realitetit të ri kontekstual shoqëror: « Një rreze dielli, / depërtoi thellë në ashtin tim, / e unë qetësisht, fola me zotat. / Pastaj e lashë shpirtin të endet i lirë, / në kërkim të yshtjeve të reja... »

Thjeshtësia dhe harmonia poetike shkrihen si një e tërë te poezia dedikuar mbesës së saj "Për Elizën": « Zëri yt simfoni e jetës, / përqaftja jote zemrën peshë ngre, / dritë e syrit i shpërthen agimet, / rreze dielli që largon çdo re. / Dhe lodroj në kopshtin e gazmendit, / Nanuris ma të bukurat melodi, / më rrëmben e qeshura e zemrës, / jetë e jetës, ëndërr, dashuri... »

Malli për vendlindjen mbetet muza e pashtershme për çdo mërgimtar, ku e bën të bubullojë në shpirt ndjenja robëruese që sjell malli për vendlindjen, si më e madhja dashuri: "Dua të ulem mbi gjunjët e malit, / atje ku dikur pata shtëpinë. / Me e lan ashtin të digjet / prej zjarrit të perëndimit, / e me u qaf me dritën e yllit, / e hanës, me i nejt karshi... »

Ndjeshmëria lirike e shpirtit të poetes preket nga stinët dhe ndërrimi i tyre, aludimi me to, i jetës së saj, i kolorit dhe ekologjisë shpirtërore: « E mugët, kjo ditë vjeshtore, / i bëhet streh trishtimit, / se i vetmi që ke

përballë, / për të ndërruar dy fjalë, / është vetvetja. »

Në mënyrë elegante autorja krijon metafora dhe konfigurime poetike të rralla, duke i artikuluar njëkohësisht thjeshtë, që tregon diskursin vetjak të unit dhe ligjëritimit poetik, si në vargjet: "Endem në ngarendje, / përmbi dete fluturoj, / dhe trazuar i lëshohem, / m'u në prehër, mallit tim".

Autorja shpesh jep edhe sentenca morale apo konstatime të verifikuara nga përvoja. Ata marrin karakter përgjithësues për nga transmetimi i mesazhit: "Mbas lotit të gruas, / fshihen të pathëna. / Ajo, botën e sheh, / me sytë e qiellit. / Çdo ditë bën me vete, / paktin e qëndrësës".

Me nota realiste autoria skicon jetën e vështirë të banorëve të qytetit minator ku ka lindur dhe ka kaluar rininë e saj. Ajo është kritike dhe nuk përpiqet ta glorifikojë dhe ta zbukurojë jetën në mënyrë subjektive: "Buzëqeshja është një relike e rrallë, / që jo gjithkush ka tagrin ta posedojë. / Dëshirat shuhet në terrin e heshtjes, / ëndrrat thahen nga bryma e dimnave. / Rroba e zezë, / që pushtuar ka shtatin e tyne, / shndërruar është në stampën / e zyrtësisë së këtij qyteti, / mbas së cilës, / ai nxiton të fshehë, heroinat e tij..."

Librat poetikë përbëjnë historinë e emocioneve të çdo autori, të punëve, të sjelljeve, të qëndrësës dhe arritjeve të tij dobiprurëse. Mendimi i çdo njeriu është një parafakt. Ajo që ndodh ka jetuar më parë në mendjen e tij. Mendja e poetëve është enciklopedia e emocioneve. Edhe faktet e vogla në bëmat vetjake, shembëlajnë me bëmat e mëdha të njerëzimit, ashtu si kriza e rëndë e njeriut i referohet krizës kombëtare. Këto mesazhe të mëdha estetike përcjell poezia e Dhurata Kolës, të cilës i urojmë: krijimtari të begatë!

*Pedagog në Albanian University, Tiranë.

SHOQATA "BULQIZA"
Atdhetare kulturore
FUSHA E VEPRIMTARISË

7. Të sigurojë bashkëpunimin me institucione qendrore, vendore e OJF, të vendit dhe të huaja, dhe me individë që kanë mundësi të japin ndihmesën e tyre në dobi të realizimit të qëllimeve të shoqatës.

Skënder Murrja – 40 vjet mësues dhe drejtor shembullor i disa shkollave

Skënder e Nadire Murrja, jo vetëm mësues por edhe bashkshortë e prindër shembullorë, e mbyllën karrierën si mësues, për të mbetur në kujtesën e mijëra nxënësve si përçues të dritës së diturisë, modele frymëzimi për komunitetet ku shërbyen, kërkues dhe të ngritur profesionalisht, ekse-lentë në fushën e mësimdhënies e të edukimit në përgjithësi.

NGA HALIL RAMA

Në dyzet vjet mësues i lëndës matematikë-fizike dhe drejtor i disa shkollave 8-vjeçare e të mesme, madje dhe drejtor i Drejtorisë Arsimore Bulqzë, Skënder Murrja ka krijuar profilin e një intelektualit me karrierë të shkëlqyer profesionale dhe njerëzore. Gjithkush do të impresionohet nga karriera e tij, nga arritjet inkurajuese në procesin e mësimdhënies e të drejtimit të shkollave me kompetencë e profesionalizëm. Ndaj dhe nuk është e lehtë të shkruash për madhësinë dhe shenjtërinë e këtij mësuesi e drejtuesi shembullor, pasi duhet t'i qasësh një punë sa të rëndësishme, po aq komplekse në karrierën e tij 40-vjeçare. Kjo edhe për faktin se sapo ishte diplomuar me rezultate të shkëlqyera në Institutin Pedagogjik, dega Matematikë – Fizikë, Shkodër ku studjoi për periudhën Shtator 1966 – Korrik 1968, djaloshi nga Hoteshi i Luznisë të rrethit Dibër, do t'i duhej ta ushtronte profesionin e shumëëndërruar të mësuesit, jo në vendloindjen e tij, por mbi 100 km larg shtëpisë, në shkollën 8-vjeçare Derjan, Mat. Por, ndonëse në këto kushte, ai që në vitin e parë të punës do të dallohej për rritjen e nivelit metodik dhe shkencor të orëve të mësimin në lëndët matematikë dhe fizikë. Dhe jo vetëm kaq. Mësuesi Skënder Murrja, gjatë viteve (01.09.1968 – 15.08.1970) që punoi si mësues i matematikës dhe fizikës në shkollën 8-vjeçare Derjan, Mat realizoi me efikasitet punën e diferencuar me grupet e nxënësve në orën e mësimin dhe jashtë saj dhe ndërkohë ishte një veprimtar i dalluar shoqëror në fshat.

MIRËNJOHJA SI SHPREHJA MË E BUKUR E KARAKTERIT TË NJERIUT

Mirënjohja si shprehja më e bukur e karakterit të njeriut, e ka karakterizuar gjatë gjithë karrierës së tij mësuesin Skënder Murrja. Edhe tani në vitet e pensionit ai vlerëson ndërhyrjen imponuese të ish-shefit të Seksionit të Arsimit Dibër, Shemsi Manjani, deri në strukturat përkatëse të Ministrisë së Arsimit për t'i transferuar atë dhe disa dibranë të tjerë, nga rrethi i Matit në atë të Dibrës. Kështu Skënder Murrja, vitin e ri shkollor 1970-1971 do ta fillonte si mësues i lëndës së matematikës në shkollën 8-vjeçare "Nexhat Agolli", Muhurr, vetëm dy orë larg shtëpisë së tij të lindjes. Këtu ai do të spikaste me talentin e tij të rrallë të mësimdhënies me shpirt krijues. Unë kam patur fatin ta kisha mësues atë vit në klasën e pestë, pikërisht në atë moshë kur fitoheshin shprehitë bazë të kësaj lënde kryesore. Si edhe bashkmoshatarët e mi të asaj



kohe, Shefqet Mikli, Shefqet Xhani, Flutura Kurti. Haki Xhani, Liman Berisha, Marie Balliu, Ibrahim Doda, Aqif Mikli, Femi Balla, Shefqet Tanushi, Maliq Lleshi, Basri Zhuzhi (si edhe gjithë brezat e rinj që ai mësoi dhe edukoi ndër vite), ndihemi krenarë për të, sepse në gjithë jetën tonë (si nxënës, studentë, mësues, etj.) nuk kemi njohur një mësimdhënës kaq të talentuar si ai, një intelektual kaq të formuar si ai, një njeri si ai, me një vullnet dhe një sistematikë shembullore në studime dhe lexime librash të ndryshëm, jo vetëm të shkencave ekzakte, por edhe të atyre artistikë.

Vetëm tre muaj pasi kishte filluar punën si mësues në Muhurr, (19.11.1970 – 23.11.1972) do të detyrohej të kryete shërbimin e detyruar ushtarak në Korçë, për t'u rikthyes po në shkollën shkollën 8-vjeçare "Nexhat Agolli", me energji të reja e dije bashkohore. Kështu në harkun kohor të tri viteve (04.12.1972 – 29.08.1975) shtoi dhe sistemoi bazën materiale dhe didaktike për lëndët matematikë e fizikë në shkollë dhe ndërkohë u bë shembull për shkollat e rajonit në realizimin e punës së thelluar me nxënës cilësorë. Në këto vite Skënder Murrja do të ishte shembull i përkryer i bashkëpunimit të ngushtë me prindërit e nxënësve për realizimin e detyrave në shkollë.

KOHA KUR DREJTONTË SHKOLLËN 8-VJEÇARE KATUND I RI, LUZNI

Viti i ri shkollor 1975-1976 do të ishte surprizë për mësuesin Skënder Murrja, pasi për herë të parë që nga mosha e fëmijërisë kthehej në shkollën e vendlindjes. Tashmë më i vlerësuar nga strukturat drejtuese të arsimit në rrethin e Dibrës, do të emërohej drejtor i shkollës 8-vjeçare Katundi i Ri. Falë përvojës si mësues shembullor në Derjan e Muhurr, Skënderi do të ndikonte në krijimin e kushteve të përshtatshme për punën e mësuesve dhe nxënësve në shkollë. Kësisoj, do të rritej niveli i punës kualifikuese në bazë shkollë si dhe të gjitha format e tjera të kualifikimit. Nërolin drejtues, Ai do

të ndihmonte dhe kontrollonte njëherazi me nivel të gjithë punën e mësuesve, veçanërisht në orët e mësimin. Këtu Skënder Murrja që kuadër mjaftë serioz, por njëherësh edhe shumë i dashur dhe me një humor gjithmonë të shëndetshëm. Ishte i veçantë, energjik, në sjellje e qëndrime dhe këto dotë ndikonin në arritjen e rezultateve të mira, si në procesin mësimor-edukativ dhe në krijimin e një klime bashkëpunimi efektiv me prindërit e strukturat vendore të pushtetit të asaj kohe.

Megjithë kushtet e vështira ekonomike, pasojë e sistemit të ekonomisë së përqëndruar në ish-koperativën bujqësore, kolektivi mësues-nxënës i kësaj shkolle do të ndikonte dukshëm në elementë të tillë, si në përmirësimin e kulturës së jetesës dhe emancipimin tërësor të shoqërisë së asaj kohe. Dhe jo vetëm si mësues e drejtor shkolle, por Skënder Murrja do të shquhej edhe si nga veprimtarët më të mire shoqëror. Gjatë atyre vite ai kreu më së miri detyrën e Sekretarit të Komitetit të Rinisë të Luznisë si dhe të anëtarit të Plenumit të Rinisë të rrethit Dibër.

MËSUES NË FUSHË ÇIDHËN DHE DREJTOR NË LUNARË, SELISHTË

Ndonëse vlerësohej për potencialin intelektual dhe si mësues e drejtues kompetent, edhe Skënder Murrja do të provonte dhe përballonte me dinjitet luftën e bërërlave dhe koniukturat e injorantëve që drejtonin organizatat bazë të Partisë e strukturat e pushtetit. Ish-drejtori i Shkollës 8-vjeçare Katund i Ri, pikërisht kur e kishte bërë këtë shkollë shembull të përvojës së përparuar në gjithë rrethin e Dibrës, do të transferohej mësues në shkollën e mesme të bashkuar Fushë-Çidhën. Por edhe këtu, në harkun kohor të katër viteve (17.08.1977 – 21.08.1981) Ai do të ishte ndër më të mirët e kolektivit pedagogjik të kësaj shkolle, ku për herë të parë, falë shembullit të tij konkret do të realizohej me sukses konkursi mësimor në lëndët matematikë e fizikë për rritjen e qëndrueshmërisë së njohurive të nxënësve, ndëkohë do të aplikoheshin konkluzionet e punëve me shkrim dhe roli i tyre për efektivitetin e formimit të nxënësve. Në këto vite do të evidentohet kujdesi i shtuar i mësuesit Skënder Murrja në gjithë veprimtarinë e punës me nxënësit e mbrëmjes për një formim sa më të plotë të tyre. Dhe pikërisht, në vlerësim të aplikimit të metodave të avancuara në procesin mësimor si dhe të vizionit të tij për një sistem arsimor bashkohor, Skënder Murrja do të emërohej drejtor i shkollës së mesme bujqësore Lunarë, Selishtë, ku për shtatë vite të drejtimit të saj (22.08.1981 – 30.08.1988) do ta bënte atë shkollë, model në rang kombëtar. Me ideimin e Seksionit të Arsimit, do të vinin në këtë shkollë për të marrë përvojë, mësues e drejtorë të disa shkollave të rrethit përta i përket ndërtimit të kabineteve mësimorë për cdo lëndë e grup lëndësh, veçanërisht për lëndët bujqësore; përhapjen e eksperiencës së përparuar të lidhjes së teorisë me praktikën në lëndët bujqësore nëpërmjet seminarit me drejtuesit e shkollave të rrethit Dibër; realizimin e treguesëve të planit ekonomik-financiar të bazës prodhuese të shkollës në kushtet e terrenit dhe të klimës, si dhe për promovimin e vlerave më të mira folklorike të zonës nëpërmjet grupit artistik të shkollës.

Dhe megjithë këto arritje, sërish do të viktimizohet nga lufta e bërërlave dhe koniukturat e kuadrove mediokër vendas, për ta kaluar mësues në shkollën 8-vjeçare Selishtë (31.08.1988 – 20.08.1990), ku

profil

Gjatë katër dekadave si mësuese ajo ka përsosur procesin e mësimdhënies, si rezultat i disa kualifikimeve që ka kryer



JO VETËM MËSUES, POR EDHE BASHKSHORT E PRIND SHEMBULLOR

Sentenca se “pas çdo burri të suksesshëm qëndron një grua e fortë” gjen mishërim të plotë edhe tek Skënder Murrja. Me bashkëshorten e tij Nadire Xhani (Murrja) ata krijuan një familje model, të vlerësuar e respektuar sinë Luzni, Muhurr, Selishtë, Çidhën, Bulqizë e Tiranë.

Edhe bashkshortja e tij Nadirja e nisi misionin fisnik të përhapjes së dritës së diturisë në shkollën e vendlindjes më 20 gusht 1975 në shkollën 9-vjeçare Fushë Muhurr, cikli i ulët. Ajo e ushtroi profesionin e mësueses edhe në shkollat Fushë-Çidhën e Selishtë dhe e mbylli më 1 shtator 2015 në shkollën 9-vjeçare “Shefqet Tançi”, qyteti Bulqizë, pas 40 vitesh në këtë profesion, sa të bukur aq edhe të përgjeg-



jshëm. Në të gjitha shkollat ku ka punuar është motivuar me certifikatë nga drejtoritë e shkollave për punë shembullore me nxënësit në procesin mësimor dhe edukativ. Por më e veçantë për të, ka qenë “Çertifikata e Mirënjohjes”, me të cilën u vlerësua nga Zyra Arsimore Bulqizë më 7 mars 2013, me motivacionin: “Për përkushtim dhe punë cilësore në procesin mësimor-edukativ në punën shumëvjeçare me nxënësit.”

Gjatë katër dekadave si mësuese ajo ka përsosur procesin e mësimdhënies, si rezultat i disa kualifikimeve që ka kryer, si: “Veprimtari pedagogjike në bazë shkollë” (në secilën shkollë) dhe “Veprimtari pedagogjike në bazë rrethi” (sot bashki), duke përfituar Shkallën e parë kualifikuese.

Me bashkëshortin e saj Skënder Murrja, një ndër mësuesit e drejtorët e shkollave më të mirë që ka patur Dibra e Bulqiza, krijuan një familje solide dhe sot u gëzohen fëmijëve: vajzës Valdete Sulejmani, mësuese e gjuhës gjermane Elona Gjyriqi, mësuese e historisë dhe Orges Murrja, mësues i edukimit fizik, edhe ky ndodhet në Angli, si dhe tri mbesave e nipit të tyre.

Skënder e Nadire Murrja, jo vetëm mësues por edhe bashkshortë e prindër shembullorë, e mbyllën karrierën si mësues, për të mbetur në kujtesën e mijëra nxënësve si përcës të dritës së diturisë, modele frymëzimi për komunitetet ku shërbyen, kërkues dhe të ngritur profesionalisht, ekselentë në fushën e mësimdhënies e të edukimit në përgjithësi.

edhe këtu, pa u demoralizuar ai dallohet për nivelin e lartë profesional të mësimdhënies.

22 VJET NË BULQIZË-EMRI I MIRË QË LA SKËNDER MURRJA SI MËSUES E DREJTUES NË SEKTORIN E ARSIMIT

Përkushtim dhe vetëm përkushtim, durim dhe vetëm durim, dashuri dhe pasion për profesionin e bukur të mësuesit...Vetëm kësaj Skënder Murrja eci suksesshëm në këtë mision fisnik edhe gjatë 22 viteve të fundit të karrierës së tij si mësues e drejtor në shkollat e qytetit të Bulqizës. Pasi kishte shërbyer me përkushtim e devotshmëri në disa shkollat të rrethit të Dibrës, pas '90-tës kur nis edhe ndryshimi i sistemit politik e për rrjedhojë edhe i atij ar-

simor në vendin tonë, Skënder Murrja transferohet në shkollat e Bulqizës.

Edhe këtu ai shpaloj rrugëtimin shumëvjeçar të punës së tij edukativo-arsimore, përvojën jetësore të mbushtur me mbresa dhe emocione. Kështu, nga viti 1990 deri më 1993, kur shërbeu si mësues dhe zëvendësdrejtor në shkollën 9-vjeçare “Shefqet Tançi” Bulqizë. Ai do t’ju dhuronte nxënësve dhe kolegëve, por edhe prindërve dashuri e ngrohtësi, buzëqeshje e çiltërsi, kënaqësi e drejtësi, mësim e dituri, shkathtësi e lumturi. Me moton: para se të jemi mësues të mirë e të dalluar, duhet të jemi edukatorë të mirë, të luajmë rolin e prindit, psikologut, pedagogut, po pse jo nganjëherë edhe të artistit, Skënder Murrja ia doli të fitojë respektin maksimal të komunitetit. Sepse me punën, përkushtimin

e profesionalizmin e spikatur ndikoi në ngritjen e nivelit të mësimdhënies veçanërisht në lëndën e fizikës nëpërmjet shtimit të bazës materiale – didaktike për realizimin e eksperimenteve për çdo orë mësimi. Po ashtu edhe në rritjen e nivelit të testimit të nxënësve në përputhje me objektivat lëndore dhe përcaktimin e detyrave konkrete në punën me nxënësit. Do të ishte Skënder Murrja që do të fuste në këtë shkollë koncepte më të avancuara nga programet e kolegjeve në punën me nxënësit cilësorë për të përballuar me sukses konkurset në bazë shkollë, rrethi dhe kombëtare.

Me të njëjtin përkushtim e profesionalizëm do të shërbente S.Murrja edhe si drejtor në shkollën 9-vjeçare “Xhevdet Doda” Bulqizë (13.09.1999 – 08.06.2003).

Strukturat drejtuese të arsimit në qarkun e Dibrës dhe rrethin e Bulqizës do ta përgjithësonin këtë shkollë si qendër të rëndësishme për shkollat e tjera të rrethit Bulqizë për edukimin e të drejtave dhe lirive themelore të fëmijëve. Po ashtu ato do të evidentonin rolin e drejtorit S.Murrja në rritjen e aktiviteteve mësimore dhe artistike në funksion të edukimit dhe mësimin; për veprimtaritë cilësore kualifikuese për të ngritur nivelin e mësimdhënies në një standard të ri në luftë me praktikën e prapambetura si dhe për standartizimin e bibliotekës së shkollës, rritjen e numrit të librave si bazë e rëndësishme për lexuesit nxënës e mësues, për përmirësimin e punës në shkollë.

Pikërisht mbi bazën e këtyre arritjeve ai do të ngjiste shkallarën e karrierës së tij deri Drejtor i Drejtorisë Arsimore të Rrethit Bulqizë (09.06.2003 – 30.04.2004) dhe Inspektor i Matematikës dhe Fizikës në Zyrën Arsimore Bulqizë (01.05.2004 – 16.09.2004). Në këto funksione drejtuese ai do të dallohej për takime efektive me të gjithë mësuesit në të tetë zonat e rrethit për të tërhequr mendimin e tyre për pyetjen: Çfarë mendoni ju se duhet bërë më mirë në shkollë, arsim dhe mbi këtë bazë në përcaktimin real të objektivave mësimorë e edukativ në shkallë rrethi, për të ngritur përmbajtjen e punës në nivel të ri, për t’ju përgjigjur si duhet kërkesave në rritje në arsim.

Nga strukturat përkatëse drejtuese në qarkun e Dibrës e Bashkinë e Bulqizës S.Murrja do të vlerësohej për rritjen e nivelit në formë e përmbajtje, të punës së komisioneve kualifikuese në bazë shkollë e rrethi, për t’ju dhënë zgjidhje problemeve të përmbajtjes së punës me nxënësin. Si ekspert shembullor ai do të ndikonte edhe në ngritjen e nivelit të veprimtarive me nxënësit cilësorë për t’ju përgjigjur me sukses kërkesave në arsimin e mesëm dhe të lartë. Ndërkohë do të realizonte studimin e mirëfilltë të punës me kuadrin për t’ju përgjigjur në kohë e me cilësi kërkesave të punës në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

VLERËSIME PUNË PËR MËSUESIN SKËNDER MURRJA

Gjatë karrierës së tij 42 vjeçare si mësues dhe drejtues në disa shkollat e institucioneve arsimore, Skënder Murrja ka marrë vlerësime maksimale, deri edhe nga Ministria e Arsimit. Kështu, më 16.04.1984 ai është vlerësuar nga Ministria e Arsimit Tefta Cami me Distinktivin “Mësues i Dalluar”, me motivacionin: “Për përgatitje të mirë ideologjike, shkencore e pedagogjike, për punë të ndërgjegjshme dhe për arritje të larta në procesin mësimor-edukativ.

Më 01.04.2002. ka marrë Certifikatën: “Shkollat pilot në Edukimin e të Drejtave të njeriut, një eksperiencë e re pune” nga Drejtore ekzekutive e QSHDNJ Kozara Kati dhe Drejtore e IS: Erlehta Mato.

Skënder Murrja është vlerësuar edhe me Certifikatën “Për kontributin e dhënë në lëvizjen sindikale në arsim” (më 26.04.2016.) nga Kryetari i FSASH Xhaferr Dobrushit.

Për 11 vite (2008-2019) ka qenë Kryetar i FSASH (Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës) për bashkinë Bulqizë.

Mjek specialist kardiolog, diabetolog dhe për sëmundje të brendshme, profesor. U lind në Peladhi, rrethi Bulqizë, më 13 gusht 1940. Mbaroi Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës në korrik 1961.

in memoriam

Homazh i vonuar për Dr. Ahmet Kamberin

DR. YLBER JANI, DIBËR

Para ca ditësh ndërroi jetë profesori, pedagogu, intelektual i vërtetë, ikona e enciklopedisë mjekësore gjithëshqiptare. Fjalët janë pak, por kujtimet dhe malli për figurën e profesorit janë dhe do të mbeten të paharruara. Figura e profesor Ahmet Kamberit do të mbetet gjithmonë e freskët në kujtimet e qindra mjekëve, specialistëve-kardiologë, doktorantëve dhe studentëve të mjekësisë nga te gjitha trojet shqiptare, punëtorëve shëndetësorë, pacientëve të panumërt, miqve, shokëve dhe të gjithë atyre që e njohën profesorin. Energjik i vendosur, punëtor i palodhshëm, vizionar dhe i guximshëm. Për njerëzit si profesor Ahmeti thuhet se kishin për se të lindnin. Të tillët nuk vdesin tërësisht, jo vetëm për atë se lanë pasardhës, por edhe për atë se ç'bënë, ç'punuan dhe çfarë veprash kanë lënë pas vetes. Sa e sa jetë të fituara nga puna e palodhshme dhe shumë profesionale në spitalin e Peshkopisë. Profesor Ahmet Kamberi do të vazhdojë të mbetet në kujtesën e brezave të tërë të pacientëve të cilët patën fatin të mjekohen nga dora dhe mendja e tij. Vizioni i qartë dhe i guximshëm për zhvillimin e shëndetësisë shqiptare, sa e sa programe shëndetësore te ideuara dhe te realizuara nga profesori si ministër i shëndetësisë, përkushtimi dhe puna e palodhshme ishin karakteristika e veçantë e tij, e cila mbetet në kujtesën e shumë profesionisteve shëndetësor, miqve dhe shokëve. Një profesionist i tillë si prof. Ahmeti, shumë i përkushtuar, do të mbetet në kujtesën e qindra e qindra studentëve të Fakultetit të Mjekësisë në Tiranë, specialistëve, doktorantëve nga të gjitha trevat shqiptare dhe më gjerë. Çfarë krenarie! Sa patriotike dhe madhështore vepra që la pas për të gjithë ne që patën këtë fat te jemi studentë, specialistë dhe doktorantë të profesor Ahmetit.

Koha jep dhe merr. Shoqatës së kardiologjisë shqiptare koha i dha një kontribuues shkencor ekselent. Sa e sa artikuj shkencorë, referime të profesor Ahmetit pasuruan bibliotekën e shoqatës, një kontribut shkencor me shume vlera, udhërrëfyes shkencor për brezat e ardhshëm të punëtorëve shkencorë. Sa e sa recensione të artikujve shkencorë në kongrese evropiane të kardiologjisë nderuan kardiologjinë shqiptare fale kontributit shkencor të profesor Ahmetit, çfarë krenarie dhe madhështie për kardiologjinë shqip-



tare. Do të mund thoja edhe shumë e shumë fjalë dhe përjetime të tjera, edhe personale, si specialist dhe doktorant i tij, për profesorin tonë të dashur, sepse ai i meriton ato.

Ndonëse nuk është e lehtë që një jetë të tillë aq e pasur, dinamike dhe shumë frytdhënëse të përshkruhet me një shkrim modest, jeta dhe veprat e tij me siguri që do të mbushin edhe faqe të tjera të shkruara në të ardhmen edhe nga kolegë, miq dhe shokë të tjerë të cilët do t'i ofronin opinionit dhe sidomos brezit të ardhshëm të mjekëve informacione edhe më të detajuara për kontributin e tij të gjithanshëm ku padyshim shëmbëlltyra e tij si mjek, pedagog, shkencëtar dhe intelektual do të mbeten në përjetësi tek të gjithë ata studentë, mjekë, specialistët-kardiologë, punëtorë shkencorë, të cilët patën fatin ta njohin për së afërmi figurën emblematike të profesor Ahmet Kamberit.

Të qoftë dheu i lehtë, profesori dhe miku im i

• Një profesionist i tillë si prof. Ahmeti, shumë i përkushtuar, do të mbetet në kujtesën e qindra e qindra studentëve të Fakultetit të Mjekësisë në Tiranë, specialistëve, doktorantëve nga të gjitha trevat shqiptare dhe më gjerë. Çfarë krenarie! Sa patriotike dhe madhështore vepra që la pas për të gjithë ne që patën këtë fat te jemi studentë, specialistë dhe doktorantë të profesor Ahmetit

shtrenjtë. I përjetshëm qoftë kujtimi për Ty. Prehu në qetësinë e parajsës i dashur dhe i paharruar miku im!

BIOGRAFIA E SHKURTUAR E DR. AHMET KAMBERIT

Mjek specialist kardiolog, diabetolog dhe për sëmundje të brendshme, profesor. U lind në Peladhi, rrethi Bulqizë, më 13 gusht 1940. Mbaroi Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës në korrik 1961. Punoi 10 vjet në Peshkopi. U specializua për sëmundje të brendshme në Spitalin Klinik Nr. 1, Tiranë, për kujdesin koronar intensiv në Stokholm, Suedi dhe për diabetologji në Paris, Francë. Punoi si kardiolog dhe nëndrejtor teknik i Klinikës Speciale, Tiranë. Punoi si kardiolog e diabetolog në ekipin mjekësor të Enver Hoxhës. Drejtor i Klinikës Speciale, ministër i Shëndetësisë dhe kryetar i Komisionit Shtetëror të Mbrojtjes së Mjedisit, nënpresident i Komitetit të 39 të OBSH-së për Rajonin e Evropës, Paris 1989. Deputet në Kuvendin e parë pluralist të Shqipërisë dhe kryetar i Komisionit për të drejtat e njeriut e pakicave etnike, profesor në Fakultetin e Mjekësisë, Tiranë, themelues i Revistës Shqiptare të Kardiologjisë, President i Shoqatës Shqiptare të Kardiologjisë, anëtar i Shoqatës Evropiane të Kardiologjisë (ESC) dhe koordinator i saj për Shqipërinë, anëtar i Komitetit të vlerësimit të abstrakteve e paraqitura në Kongreset e ESC-së.

Doli në pension në shtator 2008. Punoi në profesion të lirë në specialitetet e tij deri në fund të janarit 2023, duke përmbyllur një karrierë 62-vjeçare në kujdesin mjekësor. Autor dhe bashkautor i mbi njëqind artikujsh në revistat mjekësore shkencore shqiptare, evropiane dhe amerikane, autor i 54 referimeve në konferenca shkencore shqiptare e ndërkombëtare, bashkautor i librit "Sëmundjet e Zemrës", autor i librit "Pacienti ynë i veçantë", "Po demokracisë, jo domokracisë" si edhe autor i disa tregimeve letrare. Mban titullin FESC për merita profesionale, mban urdhrin "Flamuri i Kuq i Punës" të klasit të dytë dhe "Flamuri i Kuq i Punës" të klasit të parë për kontributin profesional e shkencor dhe për drejtimin e zhvillimin e shëndetësisë. Mban titullin "Nderi i Qarkut të Dibrës".



homazh

Lamtumirë miku e shoku ynë Sabri Toska! Do të kujtojmë me shumë respekt e dashuri ashtu siç ishte i përkushtuar e i dashtur në punë e shoqëri



Ndërroi jetë në moshën 83-vjeçare Dr.Sabri Toska mjeku i shquar e i paharruar i Bulqizës

penzës ku punoj dy muaj dhe shkon në Fakultetin e Mjeksisë në Tiranë të cilin e përfundon në vitin 1964 me rezultate shumë të mira dhe ishte njëri nga studentët më të mirë.

Në shtator të vitit 1964, Sabriu emërohet si mjek epidemiolog në qytetin e Peshkopisë, ku mbulonte të gjitha problemet epidemiologjike të rrethit Dibër dhe në shkurt të vitit 1966, doktor Sabriu transferohet në spitalin e Shupenzës si mjek i përgjithshëm, për një vit e gjysmë, deri në shtator të vitit 1968. Në shtator 1969 ai transferohet në spitalin e Bulqizës si mjek i përgjithshëm dhe në vitin 1978 ai nis specializimin si mjek obsteter- gjinekolog deri në vitin 1981, duke u kompletuar me këtë specializim që e ushtroj për shumë vite, nga janari i vitit 1981 e deri në vitin 2007, pranë spitalit të Bulqizës, ku mbuloi të gjitha rastet e specialitetit të tij si dhe rastet e urgjencave kirurgjikale bashkë me kirurgët kolegë për mjekimet e traumave nga aksidentet që ndodhnin në minierën e kromit të Bulqizës.

Në spitalin e Bulqizës dr. Sabri Toska, dha një kontribut të paharruar për kujdesin ndaj nënave e bebeve të tyre në sigurimin e jetës. Duke qenë në



çdo kohë e rast pranë të sëmurëve dhe njerëzve në nevojë. Dr.Sabri vazhdoj

të punoj edhe pasi mbushi moshën e pensionit, pasi nevoja e atij qyteti dhe dashuria për njerëzit e bënë atë që të mos ndërpresë punën edhe kur familja e tij ishte vendosur me banim në Tiranë, doktori bënte më të mirën në shërbim të bashkëqytetarëve të tij, veçanërisht të porsalindurve që vinin në jetë. Për fat të keq, një aksident rrugor që i ndodhi në Tiranë pësoj dëmtime të rënda që e bënë invalid dhe nuk mundi më të ushtroj profesionin human të mjekut pranë qytetarëve të Bulqizës. Dr.Sabri vitet e fundit i kaloi nën kujdesin e vazhdueshëm të familjes së tij shembullore, të bashkëshortes e fëmijëve. Ai me punën e sjelljen e tij mbetet në kujtesën e çdo bulqizaku, nga të gjithë fshatrat e më gjerë, që ruajnë respekt për punën e tij humane e mirësjelljen në shoqëri.

Puna dhe vepra e tij mbeten të paharruara në mendjet dhe zemrat e të gjithë atyre që e njohën e punuan me këtë njeri që do të na mungojë, por që do ta kujtojmë me shumë dashuri e respekt për punën e kujtimet e bukurra që ka lënë.

Miku ynë Sabri Toska ishte krenar për familjen e tij, bashkëshorten Habibe dhe fëmijët e tij Ilirin, e dy vajzat, për nipërit e mbesat, që i qëndruan pranë dhe e mbështetën me shumë dashuri në jetën e tij modeste në Bulqizë dhe në Tiranë. Do të na mungoi, por urtësinë e mençurinë e tij i kemi në mendje e nuk do ta harrojmë. Ndarja e tij nga jeta është një humbje e madhe për familjen, të afërmit, shokët e miqtë e tij. Kryesia e "Shoqatës Bulqiza" shpreh ngushëllime familjes, bashkëshortes Kadife, fëmijëve të tij, vëllezërve, motrave, të afërmeve e kolegëve të të ndjerit, Zoti ju dhëntë durim të tejkalonit dhimbjen!



Kompania Albchrome e vlerësoi me Çertifikatë Mirënjohje, për kontributin e tij në vite në gjeologji dhe në sektorin Energo-mekanik.

Miku ynë Jashari, ishte krenar për familjen e tij, bashkëshorten dhe fëmijët e tij, vëllezërit e motrat, që i qëndruan pranë dhe e mbështetën me shumë dashuri në jetën e tij në Bulqizë. Ndarja e tij nga jeta është një humbje e madhe për familjen, të afërmit, shokët e miqtë e tij.

Kryesia e "Shoqatës Bulqiza" shpreh ngushëllime familjes, bashkëshortes Kadife, fëmijëve të tij, vëllezërve, motrave, të afërmeve e kolegëve të të ndjerit, Zoti ju dhëntë durim të tejkalonit dhimbjen!

Lamtumirë miku e shoku ynë i dashtur Jashar Gjoka! Do të kujtojmë me shumë respekt e dashuri, ashtu siç ishte i mençur e i dashtur në familje, në punë e shoqëri kudo që punove.

Shpirti i Jasharit u prehtë i qetë në parajsë dhe i qoftë i lehtë dhe i Bulqizës! Të rrojnë e ta kujtojnë familja, të afërmit dhe të gjithë miqtë e tij!

Pregatiti: **Bashkim Lami**
8 nëntor 2023

Pregatiti: **Bashkim Lami**
29 tetor 2023

Me dt 29 tetor 2023 mësuam me hidhërim të thellë nga njoftimi i familjarëve, se ka ndërëruar jetë pas një sëmundje të rëndë në moshën 83-vjeçare mjeku i bulqizakëve, Sabri Toska. Ai ka lindur në mars të vitit 1940 në fshatin Valikardhë, të Bashkisë Bulqizë dhe ishte njëri nga katër fëmijët e Hasan Toskës. I ati i tij Hasani, ishte një njeri i thjeshtë dhe punëtor që lindi dhe rriti fëmijë të edukuar dhe të shkolluar. Sabriu shkollimin bazë e kreu në vitet 1947-1954 në Zerqan. Vazhdoi studimet në Politeknikumin Mjekësor në Tiranë të cilin e përfundon në vitin 1958 me rezultate të larta dhe emërohet si ndihmës mjek në spitalin e Shu-

HOMAZH

LAMTUMIRË JASHAR GJOKA, INXHINIERI E DREJTUESI I GJEOLGJISË SË BULQIZËS

• *Lamtumirë miku e shoku ynë Jashar Gjoka! Do të kujtojmë me shumë respekt e dashuri ashtu siç ishte i përkushtuar e i dashtur në punë e shoqëri.*

Me dt 7 nëntor 2023 mësuam me hidhërim të thellë nga njoftimi i familjarëve, se ka ndërëruar jetë nga një sëmundje e rëndë inxhinieri i çpimit dhe ish drejtuesi i gjeologjisë në Bulqizë, Jashar Gjoka.

Jashar Hamit Gjoka ka lindur në vajkal në 15 nëntor 1954. Arsimin 8 vjeçar e kreu në vendlindje dhe në vitin 1972 i jepet bursa për në shkollën e mesme për teknik çpimi në Kuçovë, ku mbaroj me rezultate të larta dhe kreu stazhin në NGJ Bulqizë. Në vitin 1977 fillon Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Gjeologji Minerave në degën e çpimit, që e përfundoj në vitin 1982.

Emrohet inxhinier çpimi në Ekspeditën Gjeologjike në Bulqizë, ku shumë shpejt u njoh me gjëndjen e sondave dhe nevojat teknike për përballimin e detyrave të kërkimit të kromit nga kjo ekspeditë. Shumë specialistë apo punonjës kanë marrë nga inxhinier Jashari këshilla teknike e teknologjike, duke e pasur atë në krah, që me devotshmëri ai realizonte detyrat e ngarkuara, pamvarsisht vështirësive. Në këtë kohë në Bulqizë u montuan edhe sondat 2000 ml për çpime të thellësisë në zbulimin e shtrirjes së trupit të kromit, që do të siguronin perspektivën e minierës me rezerva në zonën veri perëndimorë. Jashari ishte një inxhinier novator dhe bashkë me inxhinierë Flamur Sula, Halil Bushi, Sefedin Shabani, Naim Karaj, Adil Alku, Saim Keta, Sami Bruçi, Sulejman Alija Osman Rexhepi; me teknikët gjeologë Fatmir Alla, Vjollca Snalla, Peme Murati, Imerr Toluli, kryesondistët e brigadjerët e çpimit

Rakip Karaj, Pal Bilaçi, Hazis Hoxha, Selim Baloshi, Fitim Strazimiri, si dhe me personelin e oficinës së ndërmarrjes Rushit Toçi, Osman Lala, Vebi Konesha, Vebi Hyka, Ibrahim Balla, Ramiz Halili, SabedinToluli, Shaqir Xheka, Avdulla Torba, Xhemal Muharremi, kanë realizuar, arritje teknike në mbështetje të ecurisë së kërkimeve gjeologjike me shpime, në ekspediten Bulqize dhe ekspedita të tjera të NGJ Bulqizë. Në bashkëpunim përballonin me sukses problemet e vështirësitë duke arritur të realizonin zbulimet e rëndësishme të trupave të mineralit të kromit në thellësi mbi 1000 ml.

Inxh. Jashar Gjoka dallohej për analizën e problematikës teknike, për ecurin dhe zgjidhjen në kohë, kur ishte specialist, kryetar ekspedite dhe së fundi drejtor i Ndërmarrjes Gjeologjike Bulqizë në vitin 1992 deri në fund të vitit 1996. Në këtë periudhë kërkohet reforma e gjërë që përfshiu gjeologjitë në të gjithë Shqipërinë, kur Ndërmarrja Gjeologjike e Bulqizës u zvogëluua nga 1200 punonjës në një bërthamë të vogël. Jashar Gjoka prej vitit 1998 punoi në Minierën e Kromit Bulqizë, inxhinier shpimi dhe më pas drejtues i sektorit Energo-Mekanik në Minierë. Jashar Gjoka në çdo detyrë shërbeu me përkushtim dhe profesionalizëm, duke kaluar me sukses çdo sfidë, sado të vështira. Jashari ish person i dashtur, komunikues me koleget dhe punonjesit. Ai ish nje njeri i apasionuar pas teknikes dhe i kushtonte vemendjen dhe kohën e duhur. Me daljen në pension në vitin 2021 Bashkia Bulqizë dhe

Gëzuar 2024! fotoreportazh

